



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 423 Akti

Nr. 508 Vendimi
Tiranë, më 10.2.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 8.2.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seance dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Erind Reovica**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Erind Reovica, i cili nëpërmjet përfaqësueses ligjore në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Erind Reovica ka qenë oficer i policisë gjyqësore që në vitin 2006 deri në vitin 2014, kur ka filluar të ushtrojë detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Ai i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, bazuar në pikën 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Erind Reovica do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Brunilda Bektashi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara: (i) nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 24.12.2019, trupi gjyqësor vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Erind Reovica, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjyqësor komisioneren Brunilda Bektashi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Në datën 10.1.2020 ky vendim i është njoftuar subjektit dhe në datën 29.1.2020, subjekti konfirmoi marrjen e e-mail-it dhe nuk është shprehur nëse ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjyqësor.

5. Me kërkesë të protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 22.1.2020, subjekti kërkoi shtyrjen e afatit për kthim përgjigje të pyetësorit standard për arsye shëndetësore. Në datën 28.1.2021, përmes postës elektronike, subjekti u njoftua për shtyrjen e afatit për kthimin e përgjigjeve të pyetësorit standard me 20 ditë pas datës 18.3.2020.

6. Me vendimin nr. 2, datë 21.9.2021, trupi gjyqësor, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Erind Reovica; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të

provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

7. Në datën 13.1.2022, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 27.1.2022; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Në datën 25.1.2022, përmes postës elektronike, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrje afati për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit.

9. Me vendimin nr. 3, datë 27.1.2022, trupi gjykues vendosi pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit dhe shtyrjen e afatit të depozitimit të parashtrimeve deri në datën 2.2.2022, brenda orarit zyrtar, duke pasur të drejtën për të paraqitur çdo provë dhe parashtrim edhe në ditën e seancës dëgjimore, si dhe zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 3.2.2022.

10. Me kërkesën e datës 2.2.2022, përfaqësuesja e subjektit kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore për arsye shëndetësore të subjektit dhe pamundësisë së saj për të qenë e pranishme në seancën e datës 3.2.2022.

11. Me vendimin nr. 4, datë 2.2.2022, trupi gjykues vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore për në datën 8.2.2022.

12. Në datën 7.2.2022, në përgjigje të e-mail-it, datë 4.2.2022, subjekti i rivlerësimit, pasi ishte njohur me aktet e dosjes në datën 20.1.2022, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ kryesisht.

13. Në datën 8.2.2022, u zhvillua seanca dëgjimore në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ishte i pranishëm, por u përfaqësua nga av. A.S. me licencë nr. ***, sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 18.1.2022, e cila në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces administrativ kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, me qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

15. Parashikimet e pikës 2, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në nenin 4, pika 5 dhe nenin 52, pika 1, të tij, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve thelbësore që përfaqësojnë elementet e një procesi sa më objektiv mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

16. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse të vlerësimit të këtyre aftësive.

17. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli

dhe rivlerësimi për subjektin e rivlerësimit Erind Reovica, që nuk është bazuar dhe as ka qenë ndikuar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

18. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Erind Reovica ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 31.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Erind Reovica është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2005, me nr. indeksi *** dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private për vitet 2005 – 2014 dhe në vijim.

19. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Erind Reovica, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) mungesë dokumentacioni ligjor për justifikimin e pasurive; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

20. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Erind Reovica, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shpresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative; (v) sugjerime të vëzhguesit ndërkombëtar sipas pikës 11, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

21. Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting*

22. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Pasuri e luajtshme, autoveturë e markës ‘Volkswagen’, vitit 2011 nga të ardhurat e bashkëshortes në punë si notere. Vlera: 700.000 lekë (shtatëqind mijë) 100%*”. ILDKPKI-ja ka konstatuar se deklarata përputhet me dokumentacionin, por në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar automjet tip “Volkswagen” në emër të bashkëshortes në vlerën 700.000 lekë.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

23. Nga verifikimi i akteve në dosje¹ dhe deklarimeve të subjektit, rezultoi se:

- Me kontratë nr. ***, datë 30.7.2015, subjekti i ka blerë shtetasit E.P., mjetin “Volkswagen”, me targa ***, viti 2011, në shumën 700.000 lekë të paguara jashtë zyrës noteriale.
- Mjeti figuron i regjistruar në pronësi të subjektit sipas certifikatës së pronësisë së datës 26.8.2015 dhe është bllokuar pasi rezulton debitor për mospagimin e plotë të detyrimeve doganore nga ana e E.P. (shitësi), në shumën 62.275 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se nuk kishte dijeni në lidhje me këtë detyrim dhe se çdo vit paguan taksat dhe detyrimet e tjera pranë DPSHTRR-së Berat.
- Subjekti e ka deklaruar mjetin në DPV-në e vitit 2015 në vlerën 700.000 lekë dhe burimin nga puna e bashkëshortes si notere, ndërsa në DPFD (DPV) e vitit 2016 ka deklaruar vlerën në 7.000 euro, ashtu si edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 1. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se e ka deklaruar gabimisht vlerën e blerjes në DPV-në e vitit 2016 dhe në pyetësorin standard, pasi mjeti është blerë në shumën 700.000 lekë, sipas kontratës së shitjes (kjo vlerë është konsideruar si shpenzim në analizën financiare).

Nuk u konfirmuan kallëzime/procedime penale të hetuara nga subjekti për shtetasin E.P., ashtu sikurse dhe procedime penale të regjistruara në emër të tij².

24. Në lidhje me burimin, si burim krijimi në DPV-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga puna e bashkëshortes si notere për vërtetimin e të cilave ILDKPKI-ja ka administruar disa dokumente shkresore³. Bashkëngjitur pyetësorit standard subjekti ka paraqitur formularë deklarimi të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për subjektin N.R. me NIPT ***, për periudhën 2015 – 2020. Ndërsa gjatë hetimit administrativ, për të ardhura nga puna e bashkëshortes si notere me kërkesë të Komisionit janë administruar disa dokumente shkresore⁴.

Në analizë të të gjitha të dhënave të administruara, rezultoi se nga data 1.1.2015 deri në momentin e blerjes së mjetit, të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore të bashkëshortes së subjektit si notere janë në shumën 857.923 lekë, të cilat u përfshinë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare treguar në tabelën më poshtë.

<i>Përshkrimi</i>	<i>1.1.2015 – 30.7.2015</i>
Pasuritë	877 014
Autoveturë tip “Volkswagen”, viti 2011, me targa ***	700 000
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve⁵</i>	<i>177 014</i>
Të ardhurat	1 449 052
Të ardhura nga paga e subjektit	591 129
Fitimi nga noteria bashkëshortja	857 923
Shpenzimet	773 121

¹Shihni aneks nr. *** dhe aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2020, të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit.

²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresën nr. *** prot., datë 19.10.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

³Shihni nga aneks nr. *** deri në aneks nr. *** dhe nr. aneks ***, ***, ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.5.2020, të QKB-së; shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2020, të DPT-së; shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2020, të ISSH-së; shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2020, të “Raiffeisen Bank”; shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2020, të BKT-së; shkresën nr. ***, datë 6.5.2020, të “Fibank”; shkresën nr. ***, datë 7.5.2020, të “OTP Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁵Nga gjendja e likuiditeteve është pakësuar shuma 16.700 euro ose 2.340.338 lekë, e cila është tërhequr nga “Raiffeisen Bank” në datën 15.2.2015, për t’u dhënë hua tek shtetasi B. E.

Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare ⁶	501 506
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	93 979
Shpenzime transporti	67 445
Shpenzime hipoteke	110 190
Mundësia për kursime	-201 082

25. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/216, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimit: duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në datën 30.7.2015, për shkak të një balance negative në shumën prej 201.082 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

26. Në parashtrimet e tij, subjekti prapëson se, edhe pse nga ana e Komisionit, përllogaritja e fitimit të realizuar nga bashkëshortja për periudhën 7-mujore është kryer në mënyrë përpjesëtimore si një mënyrë e logjikshme, jo domosdoshmërisht të ardhurat janë realizuar në mënyrë përpjesëtimore, duke pretenduar se të ardhurat në 7-mujorin e parë të realizuara nga bashkëshortja, janë më të larta se ato të përllogaritura nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti kundërshton gjetjet e Komisionit, sa i takon shpenzimeve të transportit, si dhe shpenzimeve të hipotekës, që sipas tij⁷ janë shpenzime të zakonshme brenda shpenzimeve jetike të përllogaritura nga ILDKPKI, bazuar në anketën e buxhetit të familjes për vitin 2014. Në bazë të pretendimeve të mësipërme, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit, duke paraqitur një analizë, e cila rezulton me një balancë pozitive në shumën prej 6.553 lekësh.

Vlerësimi i Komisionit

27. Sa i takon pretendimit se të ardhurat në 7-mujorin e parë të realizuara nga bashkëshortja janë më të larta, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument, duke bërë kështu që ky pretendim të mbetet në nivel deklarativ.

Sa i takon shpenzimeve të transportit, si dhe atyre të hipotekës, Komisioni çmon se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë dhe se në analizë financiare duhet të përfshihen shpenzimet reale të evidentuara gjatë hetimit administrativ të cilat duhet t'i shtohen shpenzimeve të referencës sipas INSTAT-it. Këto shpenzime referencë të transportit dhe hipotekës, janë shërbime minimale që çdo shtetas shqiptar duhet të marrë, pa përfshirë ato specifike e të veçanta.

Në vlerësim të pretendimeve të subjektit, në analizën financiare përfundimtare, është përfshirë si e ardhur e ligjshme edhe shuma prej 648.49 euro e depozituar në llogarinë e vajzës R.R. në shkurt të vitit 2015 (trajtuar në paragrafin 40 të këtij vendimi) dhe, për rrjedhojë, rezultati financiar për periudhën 1 janar deri 30 korrik 2015, ndryshon nga -201.082 lekë në -112.058 lekë. Në përfundim, subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të blerë autoveturën objekt verifikimi.

28. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “Llogari bankare në emër të Erind Reovica, pranë ‘Credins Bank’ (llogaria e rrogës). Vlera: 28.782,53 lekë (njëzet e tetë mijë e 53). Pjesa takuese: 100 %. Me shkresën nr. *** prot., datë 11.8.2020, “Credins Bank” konfirmon

⁶Tri persona, subjekti, bashkëshortja dhe vajza e madhe, deri më 9.3.2015; katër persona pas kësaj date që përkon me lindjen e vajzës tjetër.

⁷Sipas subjektit, bazuar në anketën e buxhetit të familjes, në shpenzimet mesatare mujore ose vjetore të cilat janë përcaktuar në tabelë nga Komisioni në shumën 501.506 lekë, përfshihen, ndër të tjera, shpenzimet për transport në vlerën 6,8% të këtyre shpenzimeve, mobilim pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës në masën 5,4%, si dhe shpenzime qiraje dhe shpenzime të tjera për mallra dhe shërbime në masën 6%. Sipas tij, këto lloje shpenzimet në masën më shumë se 20% përfshijnë shpenzimin e transportit, si dhe shpenzimin që ka kryer në ZVRPP.

llogarinë e pagës së subjektit dhe gjendjen e deklaruar prej tij në deklaratën *Vetting*. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin bankar.

29. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Llogari bankare në emër të Erind Reovica pranë ‘Raiffeisen Bank’ shumë e kursyer nga puna nga puna si oficer i policisë gjyqësore. Vlera: 3.300 euro (tre mijë e treqind). Pjesa takuese: 100 %*”.

30. Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këtë llogari, u konstatua se:

- Me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2020, “Raiffeisen Bank” konfirmon llogarinë e subjektit në euro dhe gjendjen e deklaruar prej tij në deklaratën *Vetting*. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin bankar.

- Në DPV-në e vitit 2014 subjekti e ka deklaruar këtë llogari dhe gjendjen e saj në vlerën 3.300 euro, por pa deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume. Nga lëvizjet e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”, është evidentuar se origjina e kësaj shume është depozitimi në *cash*, në llogarinë e tij i shumës 20.000 euro, në datën 4.7.2014. Në të njëjtën datë është çelur një depozitë me afat 6-mujor në shumën 16.700 euro, duke mbetur kështu në llogari shuma 3.300 euro. Në datën 4.7.2014, shuma 3.300 euro është transferuar në llogarinë e subjektit në këtë bankë, për t’u përdorur për kartën e kreditit.

31. Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme të mjaftueshme të subjektit për të depozituar shumën fillestare prej 20.000 euro (trajtuar hollësisht në paragrafin 84 të këtij vendimi) dhe, për rrjedhojë, edhe shumën 3.300 euro, gjendje në llogari në datën 31.1.2017. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/216, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

32. Në parashtrime, subjekti ka kundërshtuar këtë konstatim duke paraqitur argumentet e veta dhe një analize financiare të kryer prej tij. Në përfundim të procesit u vlerësua se, subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me të ardhura të ligjshme të krijimit të shumës 20.000 euro, nga e cila rrjedh shuma 3.300 euro deklaruar në llogarinë bankare objekt verifikimi (trajtuar hollësisht në paragrafët 86 e 87 të këtij vendimi).

33. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar dy llogari bankare në emër të dy vajzave të tij, si vijon: (i) *llogari bankare në emër të R. R. të ardhura si dhuratë e gjyshërve dhe dajës. Vlera: 2,624,21 euro (dy mijë e 624 e njëzet e një). Pjesa takuese: 100 %*; (ii) *llogari bankare në emër të J. R. të ardhura si dhuratë nga gjyshërit dhe daja. Vlera: 500 euro (pesëqind). Pjesa takuese: 100 %*. ILDKPKI-ja ka konstatuar se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të justifikuar të ardhurat nga gjyshërit dhe daja që kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitave.

34. Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këto dy llogari bankare, u konstatua se:

- Subjekti ka kryer deklarime të sakta në DPV-të për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

- Me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2020, “Raiffeisen Bank” i ka konfirmuar ato sipas deklarimeve të subjektit.

- Nga lëvizjet e llogarisë së vajzës R.R., janë evidentuar veprimet e mëposhtme: (i) llogaria është çelur në datën 31.12.2013; (ii) në datën 31.12.2013, është derdhur shuma 500 euro; (iii) në datën 20.2.2014 është derdhur shuma 1.000 euro. Të dyja shumat e mësipërme mbajnë përshkrimin “*T.R. derdhje*”; (iii) në datën 23.2.2015 janë depozituar shumat 520 euro dhe 128.49 euro, të dyja me përshkrimin “*S.P. derdhje*”.

- Nga lëvizjet e llogarisë së vajzës J.R., ka rezultuar se në datën 11.4.2016, është kryer një depozitim në shumën 500 euro me përshkrimin “*S.P. derdhje*”.

35. Sa i takon burimit të të ardhurave për derdhjen e shumave nga T.R. dhe S.P., pas verifikime u konstatua se:

35.1. Nga aktet e ndodhura në dosjen e ILDKPKI-së⁸ dhe akte të ndodhura në faqen zyrtare qkb.gov.al, rezulton se shtetasi T.R. (babai i subjektit) është: (i) ortak zotërues i 50% të kuotave të kapitalit themeltar në shoqërinë “T.” sh.p.k., me NIPT *****, regjistruar në datën 20.2.1995 dhe zotëron një kapital në shumën prej 14.350.000,00 lekësh; (ii) ortak zotërues i 35% të kuotave të kapitalit themeltar në shoqërinë “P.S.O.” sh. a., me NIPT *****, regjistruar në datën 10.5.2010, larguar në datën 19.9.2011 me shitje aksionesh; (iii) sipas kontratë shitje aksionesh nr. ***, datë 25.8.2011, T.R. i shet 700 aksione që zotëron shtetasit D.N. në shumën 700.000 lekë. Nuk ka të dhëna nëse për shumën prej 700.000 lekësh, përfituar në gusht të vitit 2011, është paguar tatimi mbi të ardhurën.

35.2. DRT-ja Berat informon se shoqëria “T.” sh.p.k., ka këto të dhëna për qarkullimin dhe fitimin.

Viti	Qarkullimi	Fitimi
2014	0	-5 783
2 015	1 811 783	1 470 725
2 016	1 610 250	1 211 697

Kjo shkresë nuk informon nëse është shpërndarë dividend apo që shtetasi T.R. ka marrë pagë nga kjo shoqëri.

35.3. Nga verifikimi në faqen *online* të QKB-së u verifikuan bilancet e publikuara të shoqërisë “T.” sh.p.k.⁹, si dhe çdo vendim i asamblesë së ortakeve, për të kuptuar nëse shoqëria ka shpërndarë dividend. Nga të dhënat e kësaj faqeje nuk rezultoi që të jetë shpërndarë dividend nga kjo shoqëri deri në vitin 2016.

35.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk ka paraqitur dokumente shkresore për të vërtetuar të ardhura të babait të tij T.R. dhe shtetasit S.P.

35.5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se shumata e depozituara nga S.P. (daja i fëmijës) janë kursime familjare të subjektit dhe dhurata të prindërve T. dhe M.R., por për shkak angazhimeve këto shuma janë derdhur nga S.P. Ky deklarim bie në kundërshtim me deklaratën *Vetting* dhe DPV-në për vitin 2016, ku si burim i dy llogarive bankare objekt verifikimi janë deklaruar të ardhura si dhuratë të gjyshërve dhe dajës. Ndërsa për sa i përket të ardhurave të prindërve, subjekti deklaroi se babai i tij është pronar dhe aksionar i shoqërisë “T.” sh.p.k. (ish-hotel turizmi, Berat), themeluar në datën 20.2.1995, por nuk paraqiti dokumente që të vërtetojnë të ardhura të tij që rrjedhin nga shpërndarja e dividendit apo nga paga në këtë shoqëri. Ndërkohë, subjekti deklaroi se nëna e tij ka qenë e punësuar si mjeke në spitalin rajonal Berat dhe paraqiti disa dokumente shkresore¹⁰, nga verifikimi i të cilave ka rezultuar se të ardhurat nga paga e nënës për periudhën janar 2010 deri 20.2.2014 (kur është kryer depozitimi i fundit nga T.R.), janë në total në shumën 677.724 lekë. Ndërsa shpenzimet e llogaritura për të njëjtën periudhë për prindërit e subjektit, janë në shumën 1.180.957 lekë. Sikurse evidentohet, të ardhurat e nënës nuk janë të mjaftueshme për të krijuar shumata e depozituara nga babai T.R. në llogarinë e vajzës së subjektit R.R. prej 500 euro dhe 1.000 euro.

⁸Shihni aneks nr. ***-*** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹Bilanci i 1-rë i publikuar në QKR është ai i vitit ushtrimor 2007 dhe i fundit ai i vitit 2020.

¹⁰Shihni: (i) llogari page të M.R. nga “Alpha Bank”, nga data 1.1.2010 deri 18.10.2021; (ii) llogari nr. ****, të M.R. nga “Credins Bank”, datë 9.11.2021, për periudhën 9.1.2014 – 21.11.2020, ku evidentohen paga nga spitali rajonal Berat; (iii) llogari nr. ****, të M.R. nga “Credins Bank”, datë 9.11.2021, për periudhën 28.6.2016 – 28.6.2019; (iv) llogari nr. **** të M.R. nga “Credins Bank”, datë 9.11.2021, për periudhën 28.6.2016 – 28.6.2019; (v) ekstrakt historik, datë 9.11.2021, i shoqërisë “T.” sh.p.k., me NUIS ***, ku z. T.R. figuron ortak 100 %; (vi) katër llogari në emër të z. T.R. pranë “Procredit Bank”, të periudhës 1.1.2000 – 11.8.2021 (llogari kursimi individuale në euro ****, llogari kursimi individuale në lekë, llogari rrjedhëse për individë në lekë, llogari rrjedhëse për individë në euro”).

Bazuar në sa më sipër, shumat e depozituara nga shtetasit T.R. dhe S.P. në emër të vajzave R. e J.R., janë konsideruar si shpenzime të subjektit të rivlerësimit në analizën financiare të viteve përkatëse, dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

36. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimit: duket se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme krijimin e llogarive bankare në emër të vajzave R. e J.R.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

37. Subjekti parashtroi se, nga lëvizjet e llogarive bankare rezulton qartësisht se pjesa më e madhe e vlerave monetare në llogaritë bankare janë depozituar nga babai i tij përpara se të fillojë detyrën, duke shpjeguar se nuk ka informacion të plotë për fitimet e realizuara nga babai i tij, por ai vë në dukje faktin se babai i tij është ortak dhe administrator i hotel “T.”, Berat, dhe se nga lëvizjet e llogarive bankare, sipas tij, rezulton se të ardhurat e këtij aktiviteti janë shumë të mira, pasi të paktën ka marrë një rrogë minimale si administrator. Gjithashtu, sipas subjektit, provohet se prindërit e tij vetëm nga pagat për periudhën 2000 – qershor 2014, kanë realizuar të ardhura të mjaftueshme për të depozituar para në llogarinë e vajzave, si dhe për të financuar një pjesë të shpenzimit në vitin 2013 në BKT. Në këtë mënyrë, subjekti kundërshtoi përlllogaritjen e të ardhurave të babait në shumën 0 (zero) lekë, nga Komisioni.

38. Sa i takon të ardhurave të dajës së vajzave, S.P., subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar: “... ndërsa shuma e depozituar, pasi unë kam filluar detyrën në llogaritë e të dyja vajzave të mija në shumën totale 1,148.49 euro, pavarësisht se është derdhur nga daja i vajzave, Komisioni e ka përfshirë në analizën financiare të familjes time...”. Ky pretendim është i pakuptimtë, jo vetëm për faktin se subjekti nuk ka vërtetuar në asnjë moment të ardhura të shtetasit S.P., por edhe për faktin se ai gjatë gjithë procesit ka deklaruar se vlerat e depozituara prej tij nuk kanë qenë më të ardhura të këtij shtetasi, por të prindërve të subjektit.

39. Për të provuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur së bashku me parashtrimet e tij dokumente shkresore të cilat vërtetojnë të ardhura të prindërve të tij, si vijojnë:

- dosje e plotë pensioni për znj. M.R., bashkëlidhur së cilës ndodhen të ardhurat nga pagat për periudhën 1994 deri shtator 2019 dhe pas kësaj date pensioni i saj;
- dosje e plotë pensioni për z. T.R., bashkëlidhur së cilës janë pagat e përfituara nga ky shtetas nga viti 1996 deri në dhjetor 2011 dhe pensioni i përfitur prej datës 1.1.2012;
- bilancet e shoqërisë “T.” sh.p.k., për periudhën 2011 – 2014;
- shkresë nr. *** prot., datë 2.2.2022, nga Bashkia Berat, e cila vërteton pagesën e taksave dhe tarifave vendore të kësaj shoqërie për periudhën 2010 – 2021.

Vlerësimi i Komisionit

40. Në analizë të dokumenteve shkresore, u konstatua se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme për të mundësuar derdhjet në depozitat objekt verifikimi në emër të vajzave të tij. Në përfundim, pavarësisht se në deklaratën *Vetting*, këto llogari bankare janë deklaruar me burim dhuratë nga gjyshërit dhe daja, referuar vlerës së vogël të depozitave me përshkrimin “S.P. derdhje”, në analizën përfundimtare financiare, të gjitha shumat e depozituara u konsideruan si të dhuruara me të ardhura të ligjshme nga prindërit e subjektit, dhe jo si shpenzime të subjektit të rivlerësimit.

41. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Apartament në qytetin e Vlorës, blerje nga kursimet e emigrimit në Itali dhe ndihmë financiare nga prindërit. Vlera: 34.800 euro. Pjesa takuese: 100 %”. Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit të apartamentit në Vlorë me sip. 34.8 m² dhe vlerë 34.800 euro, nga kursimet e emigrimit në Itali dhe ndihmë financiare nga prindërit. Është i paqartë çmimi prej 34.800 euro për apartamentin me sip. 34.8

m² në kontratën e shitblerjes së vitit 2014, ndërsa sipas kontratës së porosisë së vitit 2011, vlera e apartamentit është 28.100 euro, konfirmuar nga DPPPP-ja.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

42. Në lidhje me statusin aktual të pasurisë dhe përdorimin e saj, u konstatua se:

42.1. ASHK-ja Vlorë ka konfirmuar të regjistruar në emër të subjektit pasurinë e paluajtshme apartament me sip. 34.8 m², me nr. pasurie ****, Vlorë. Ndërkohë, FSHU-ja dhe UK-ja Vlorë kanë informuar se me gjeneralitetet Erind T. Reovica nuk rezulton të ketë abonent¹¹.

42.2. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se nuk është lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike dhe ujë, pasi nuk ka banuar asnjëherë në këtë banesë. Duke qenë se në dokumentin “raport vlerësimi të pasurisë”, datë 26.4.2019, rezulton se ky apartament ka burim energjie dhe uji, të lidhura me rrjetin kryesor të shpërndarjes, u pyet sërish subjekti nëse ky apartament është furnizuar ndonjëherë me energji elektrike dhe ujë, i cili në përgjigjet e dërguara me e-mail të datës 11.10.2021, ka shpjeguar se në vitin 2015 ka bërë pagesë për një abonent me numër kontrate ***, në emër të shtetasit Th.P., duke vënë në dispozicion mandatar-këtimin datë 12.8.2015, ku figurojnë faturime në shumën totale prej 24.677,25 lekësh, për periudhën shkurt 2012 – korrik 2015 në emër të këtij shtetasi. Po kështu, me kërkesë të Komisionit, FSHU-ja konfirmoi¹² se kontrata me nr. ***, me kod klienti ***, i përket abonentit Th.P. e hapur në datën 7.2.2012.

42.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se shtetasin Th.P. nuk e njej dhe nuk ka asnjë marrëdhënie me të dhe se kontrata ishte lidhur në emër të tij nga ana firmës ndërtuese, përpara se subjekti të blinte pasurinë, po pa paraqitur ndonjë dokument shkresor që të vërtetonte këtë deklaram. Subjekti paraqiti librezën e energjisë në emër të z. T.P., ku vërehen vetëm pagesat e periudhës janar 2021 – tetor 2021, me tarifë fikse në vlerën 340 lekë. Gjithashtu, deklaroi se pasuria nuk është dhënë me qira asnjëherë dhe ka përsëritur se pasuria nuk është përdorur prej tij, por për një periudhë të shkurtër është përdorur nga ndonjë shok i tij.

42.4. Nuk u konfirmuan kallëzime/procedime penale të hetuara nga subjekti për shtetasin Th.P., ashtu sikurse dhe procedime penale të regjistruara në emër të tij¹³.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar deklarameve të subjektit dhe faturimeve për shpenzimet e energjisë elektrike, duket se subjekti nuk e ka përdorur apartamentin objekt verifikimi.

43. Në lidhje me mënyrën e krijimit të pasurisë dhe deklaramet e subjektit, nga aktet në dosje¹⁴ rezulton se në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

- Sipas vërtetimit hipotekor të datës 1.2.2012 të ZVRPP-së Vlorë, apartamenti figuron i regjistruar në pronësi të shoqërisë “R.” sh.p.k., me nr. pasurie ***, me sip. 34.8 m², në adresën lagjja “****”, Vlorë, objekti “**** kate, me *** kate pjesërisht banimi dhe parkim nëntokë, ***

¹¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Vlorë, bashkëngjitur kartelës së pasurisë; shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020, të FSHU-së; shkresën nr. *** prot., datë 14.10.2021, të UK-së Vlorë.

¹²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2021, të FSHU-së, në dosjen e Komisionit.

¹³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

¹⁴Shihni aneks nr. ***. Subjekti ka paraqitur si prova: kontratë nr. ***, datë 9.7.2014; vërtetim hipotekor nr. ***, datë 1.2.2012, lëshuar më 1.2.2012; hartë treguese të pasurisë nr. ***, certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr. ***, z. k. ***, lëshuar nga ZVRPP-ja Vlorë; si dhe aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 13.5.2020, të DPPPP-së në dosjen e Komisionit dhe shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2017, të DPPPP-së në aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

kat njësi shërbim, *** kat banim”, sh. ***, k. ***, ap. ***. Bashkëngjitur vërtetimit ndodhen hartë treguese dhe planimetri apartamenti.

- Sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 9.7.2014, shoqëria “R.” sh.p.k., i ka shitur subjektin pasurinë nr. ***, në çmimin 34.800 euro të likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale. Subjekti e ka deklaruar apartamentin në DPFID-në e vitit 2014.

- Sipas certifikatës për vërtetimin e pronësisë nr. *** dhe kartelës së pasurisë, në pronësi të subjektit është regjistruar pasuria nr. ***, e llojit apartament me sip. 34.8 m².

44. Siç vërehet, në kontratën e shitjes së pasurisë dhe dokumentet shoqëruese përcaktohet numri i pasurisë ***, ndërsa në kartelën e pasurisë dhe certifikatën e pronësisë përcaktohet numri i pasurisë ***. Për t’u qartësuar në lidhje me këto mospërputhje, u kryen veprimet hetimore si vijojnë:

44.1. Iu kërkuan sqarime subjektit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka shpjeguar se është pronar i pasurisë nr. ***, vërtetuar kjo sipas certifikatës së pronësisë dhe se ndryshimi i numrit mund të ketë ardhur si pasojë e regjistrimit fillestar të qytetit të Vlorës.

44.2. U kërkua informacion nga ASHK-ja Vlorë, nëse pasuria me nr. *** është e njëjta pasuri me nr. *** dhe mbi arsyet e ndryshimit të numrit të pasurisë. ASHK-ja Vlorë¹⁵ ka konfirmuar se pasuria nr. ***, me sip. 34.8 m², në pronësi të shtetasit Erind Reovica, është i njëjtë me apartamentin me nr. pasurie *** dhe se numri i pasurisë është ndryshuar nga menaxhimi.

44.3. I është kërkuar informacion shoqërisë “R.” sh.p.k., e cila konfirmon se subjekti ka blerë vetëm një pasuri prej saj, atë të përcaktuar në kontratën e shitjes nr. ***, datë 9.7.2014, ku pasuria ka nr. ***, apartament me sip. 34.8 m².

45. Sipas informacionit të sjellë nga DPPPP-ja¹⁶, mes subjektit dhe z. D.Ç. (administratori i shoqërisë “R.” sh.p.k.) është lidhur një kontratë noteriale me nr. ***, datë 9.2.2011, në vlerën 28.100 euro, për prentim apartament banimi me sip. 28.1 m² në kompleksin rezidenca “M.M.***”, Vlorë. Ndërsa, në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI¹⁷, në procesverbalin, datë 18.3.2016, subjekti ka deklaruar se *kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 9.7.2014, është hartuar në përmbushje të kontratës së porosisë, e cila ka qenë hartuar më parë, fakt ky i përmendur në kontratën e shitjes*. Subjekti ka vënë në dispozicion të ILDKPKI-së kontratë shitjeje nr. ***, datë 9.7.2014, e cila nuk e përmend kontratën e porosisë, ashtu sikurse subjekti deklaroi, si dhe certifikatë pronësie të pasurisë nr. ***, z. k. ***, të apartamentit në Vlorë, me sip. 34.8 m². Ndërkohë, subjekti nuk e ka paraqitur kontratën e porosisë pranë ILDKPKI-së.

46. Me qëllim qartësimit të situatës në lidhje me kontratën e prentimit/porosisë së përmendur në shkresën e DPPPP-së dhe në deklaratimet pranë ILDKPKI-së, u kryen veprimet hetimore si vijojnë:

46.1. Iu kërkua informacion subjektit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, paraqiti kontratën e prentimit me aktin noterial me nr. ***, datë 9.2.2011 dhe ka dhënë shpjegime, duke lënë të kuptohet se midis palëve është lidhur fillimisht kjo kontratë për porositjen e një apartamenti banimi me sip. 28.1 m² dhe, në vijim, me marrëveshje të palëve, është rënë dakord që subjekti të përfitojë një apartament tjetër me sip. 34.8 m², objekt i kontratës së shitjes të vitit 2014.

46.2. I është kërkuar informacion shoqërisë “R.” sh.p.k., e cila, me shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2021, ka përcjellë kontratë prentimi nr. ***, datë 9.2.2011, për apartamentin me sip. 28.1 m², me çmim 21.000 euro dhe kontratë nr. ***, datë 9.7.2014, për shitjen e apartamentit me nr. pasurie ***, me sip. 34.8 m², me vlerë 34.800 euro, duke sqaruar se shoqëria “R.”

¹⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 5.11.21, bashkëngjitur origjinën e pronës, kontratën e shitjes nr. ***, datë 9.7.2014; kopje karteletë të pasurisë me nr. ***, kopje të nenit hipotekor, e cila vërtetohet prejardhjen pasurisë nga ***-***.

¹⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.5.2020, të DPPPP-së në dosjen e Komisionit.

¹⁷Shihni shkresën nr. ***prot., datë 20.10.2021, në dosjen e Komisionit.

sh.p.k., nuk ka lidhur asnjë kontratë tjetër në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të. Gjithashtu, kjo shoqëri konfirmon se: “*Pavarësisht dy kontratave, ka vetëm 1 apartament të shitur, sipas kontratës nr. ***, datë 9.7.2014. Kontrata e vitit 2011 është anuluar me marrëveshje mes palëve, pasi klienti ka kërkuar një sipërfaqe më të madhe në të njëjtin objekt. Duke qenë se apartamenti në fjalë ishte akoma i pa shitur dhe çmimi për metër katror ishte i njëjtë (1.000 euro/m²), palës porositëse i është kaluar në posedim në vitin 2012 apartamenti tjetër me sip. 34.8 m², për të cilin është formalizuar dhe shitja në vitin 2014 kur u bë regjistrimi i gjithë godinës*”.

46.3. Iu kërkuar noteres A.M. informacion në lidhje me veprime të kryera nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka informuar se në zyrën e saj noteriale është lidhur kontrata e prenotimit nr. ***, datë 9.2.2011 dhe kontrata e blerjes nr. ***, datë 9.7.2014¹⁸. Nga të dhënat e RNSH-së, figuron të jetë regjistruar vetëm kontrata e shitjes¹⁹.

46.4. Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku subjekti ka ushtruar detyrën, nuk konfirmuan kallëzime/procedime penale të hetuara nga subjekti për shtetasin D.Ç. dhe shoqërinë “R.” sh.p.k. Ndërkohë, SPAK nuk ka konfirmuar procedime penale të regjistruara në emër të shtetasit D.Ç.

46.5. Bazuar në të dhënat e administruara më sipër, duket se subjekti fillimisht ka prenotuar një apartament banimi me sip. 28.1 m² dhe, më pas, me marrëveshje të pashkruar midis palëve, në vend të tij, ka blerë një tjetër apartament me sip. 34.8 m². Ky fakt bëhet i besueshëm, pasi: (i) referuar sipërfaqeve të të dyja apartamenteve nuk ka ndryshim në çmimin për metër katror; (ii) nuk ka të dhëna nga ASHK-ja Vlorë dhe nga asnjë burim tjetër i ligjshëm, që subjekti të ketë në pronësi dy apartamente në qytetin e Vlorës.

47. Sa i takon çmimit të blerjes së pasurisë, sipas udhëzimit Nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2010”, për zonën O., Vlorë, ku ndodhet apartamenti, çmimi në tregun e lirë për vitin 2011 është 48.600 lekë/m². Pra, referuar çmimit referencës, apartamenti i blerë do të kushtonte 34.8 m² x 48.600 lekë/m² = 1.691.280 lekë ose 12.185 euro²⁰, ndërkohë që ka kushtuar 34.800 euro. Vërehet se subjekti e ka blerë pasurinë me një çmim prej rreth 3 herë më të lartë se ai i referencës.

Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë

48. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka specifikuar si burim për blerjen e këtij apartamenti, kursimet e emigrimit të Itali dhe ndihmë financiare nga prindërit. Ndërsa, në DPFD në vitin 2014, subjekti ka deklaruar si burim krijimi vetëm kursimet e emigrimit në Itali.

49. Për të verifikuar mundësinë e subjektit, për të blerë me të ardhura të ligjshme pasurinë objekt verifikimi, është bërë e domosdoshme të përcaktohet periudha kur është paguar çmimi i shitjes prej 34.800 euro. Konkretisht, Komisioni është ndodhur përpara këtyre fakteve:

49.1 Në kontratën e prenotimit nr. ***, datë 9.2.2011, është parashikuar se pagesa prej 28.100 euro do të kryhet me marrëveshje midis palëve, por pa përcaktuar një kohë të saktë të pagimit të çmimit dhe të mënyrës së likuidimit.

49.2 Në deklaratimet e tij, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: “... *likuidimi është bërë në datën e lidhjes së kontratës së prenotimit nr. ***, datë 9.2.2011, totalisht në shumën 28.100 euro, por më vonë me marrëveshje me palën investitore është ndryshuar sipërfaqja e apartamentit nga 28.1 m² në 34.8 m², kështu çmimi i shitjes ka ndryshuar nga*

¹⁸Shihni shkresën datë 12.10.2021, të noteres A.V M., në dosjen e Komisionit.

¹⁹Shihni shkresë nr. *** prot., datë 12.5.2020, të MD, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira, në dosjen e Komisionit. Sipas kësaj shkrese jepen të dhëna për veprimet, aktet noteriale, duke filluar nga data 1.3.2013.

²⁰Kursi i këmbimit 1 euro = 138.81 lekë, datë 31.12.2010, Banka e Shqipërisë.

28.100 euro në 34.800 euro dhe diferenca e çmimi prej 6.700 euro është bërë në vitin 2012 pranë shoqërisë 'R.' sh.p.k. Pagesa është bërë cash në dorë pranë shoqërisë pasi në bazë të kontratës së prenotimit nuk ka qenë detyrim ligjor kalimi i çmimit shitblerjes nëpërmjet numrit të posaçëm të noteres për tjetërsim pasurie...". Subjekti nuk ka paraqitur dokumente shkresore për të vërtetuar deklaratimet e tij.

49.3 Noterja A.M. ka konfirmuar se nga praktikat për kontratat për prenotim apartamenti, çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës kryhej me marrëveshje midis palëve jashtë zyrës noteriale.

49.4 Në kontratën e shitjes nr. ***, datë 9.7.2014, parashikohet se shitësi ia shet pasurinë blerësit kundrejt çmimit 34.800 euro, likuiduar tërësisht jashtë kësaj zyre noteriale.

49.5 Me kërkesë të Komisionit shoqëria "R." sh.p.k. ka konfirmuar deklaratimet e subjektit, duke informuar²¹ se pagesat janë kryer të plota cash dhe se blerësi ka paguar shumën 28.100 euro në vitin 2011 sipas kontratës, datë 9.2.2011. Në vitin 2012 është paguar diferenca, kur u kalua nga apartamenti me sip. 28.1 m² në atë me sip. 34.8 m². Për sa i përket dokumentacionit justifikues, shoqëria informoi se nuk disponon dokumente bankare, pasi likuidimet janë bërë në cash, si dhe për shkak të kohës së gjatë, nuk disponojnë mandatarkëtime.

49.6 Në mungesë të akteve shkresore, që të provojnë datën e saktë dhe shumat e paguara për blerjen e apartamentit me kontratën e shitjes datë 9.7.2014, pra, tre javë pasi subjekti ka filluar detyrën (më 20.6.2014), Komisioni i është referuar deklaratimeve të subjektit dhe administratorit të shoqërisë "R." sh.p.k., sipas të cilave: (i) shuma 28.100 euro është paguar në datën 9.2.2011 (data e hartimit të kontratës së prenotimit); (ii) diferenca e mbetur prej 6.700 euro është paguar brenda vitit 2012. Pra, pagesa e shumës 34.800 euro është konsideruar e kryer me të ardhura përpara se subjekti të fillonte detyrën në vitin 2014.

Analizë e burimeve të deklaruara nga subjekti

50. Sa i takon burimit të të ardhurave nga emigracioni, nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së ka rezultuar se në datën 19.12.2005 subjekti është emëruar si OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Durrës dhe në datën 13.1.2006 ka firmosur dhe dorëzuar DPFDP-në pranë ILDKPKI-së. Në këtë deklaratë, subjekti deklaroi se ka gjendje cash shumën 60.000 euro të krijuar gjatë viteve 1997 – 2005, pa deklaruar burimin. Ndërsa në rubrikën "të ardhura" ka deklaruar të ardhura nga paga vjetore në shumën 30.000 euro, nga emigracioni në Itali.

51. I pyetur nga ILDKPKI-ja, në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes cash, subjekti, në shpjegimet e dhëna në procesverbalin e datës 27.1.2016, ka deklaruar se burimi i krijimit të gjendjes cash është nga emigracioni në Romë, Itali.... gjatë këtyre viteve ka punuar në të zezë, i paregjistruar... sqaron se ka pasur leje qëndrimi në shtetin italian, por për shkak të periudhës së gjatë kohore nuk është i sigurt nëse e disponon.

52. I pyetur përsëri nga ILDKPKI-ja në datën 18.3.2016, subjekti ka deklaruar se si burim për shumën 60.000 euro në vitin 2005 kanë shërbyer të ardhurat nga emigracioni dhe ndihma financiare nga babai, i cili ka pasur biznesin hotel "T.", Berat, nga viti 1994, por nuk ka specifikuar as se çfarë shume vjen nga secili burim, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues në mbështetje të këtyre deklaratimeve.

53. I pyetur nga Komisioni mbi burimin e të ardhurave nga emigracioni dhe ndihmën financiare të prindërve për blerjen e apartamentit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk ka dhënë sqarime, si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për të vërtetuar këto të ardhura apo ndonjë dokument tjetër për të provuar qëndrimin e tij në shtetin italian.

²¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2021, të shoqërisë "R." sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

54. I pyetur përsëri në mënyre të detajuar për qëndrimin dhe punësimin në Itali, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka kryer këto deklaratime:

54.1. Sa i takon qëndrimin në Itali, fillimisht ka shkuar për arsye studimi dhe është pajisur me leje qëndrimi në datën 4.9.1997, më pas, e rinovuar deri në datën 31.12.2000. Pas datës 31.12.2020 ka shkuar përsëri në Itali i pajisur me vizë. Për sa i përket banimit në Itali, subjekti ka deklaruar se ka qëndruar vetëm në qytetin e Romës, fillimisht në konvikt dhe, më pas, ka marrë apartament me qira, shpenzim i ndarë me disa miq të tij. Ndërsa, vlerën e qirasë deklaroi se nuk e mban mend për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Për të provuar qëndrimin e tij në Itali, subjekti paraqiti disa dokumente shkresore²² nga të cilat duket se subjekti ka provuar qëndrimin e tij në Itali, si student, për periudhën shtator 1997 – 31.12.2000. Pas kësaj periudhe, subjekti nuk ka përcaktuar kohën, vendin dhe arsyet e qëndrimin, si dhe nuk paraqiti asnjë dokument shkresor.

54.2. Sa i takon punësimin në Itali, subjekti ka deklaruar se ka punuar në rrethinat e Romës, kryesisht në bujqësi dhe në zyrë mobilare. Në lidhje me punësimin në bujqësi, subjekti nuk paraqiti ndonjë dokument, si dhe nuk dha informacion mbi vendndodhjen e saktë të punëdhënësve apo periudhat e sakta të punësimit. Ndërsa, në lidhje me punësimin në zyrë mobilare paraqiti një shkresë të datës 8.11.2021, të shtetases B.B., administratore e vetme e shoqërisë “P.” s.r.l., Romë, me aktivitet kryesor në sektorin e ndërtimit të pasurive të paluajtshme, e cila deklaroi se në periudhën 1997 – 2000 shtetasi Erind Reovica, student pranë universitetit “*****”, Romë, ka bashkëpunuar me këtë shoqëri, duke marrë si shpërblym shumën 2.000.000 lireta/muaj. Kjo shkresë edhe nëse do të ishte e vlefshme për efekt provueshmërie, nuk tregon nëse për ato të ardhura janë paguar detyrimet tatimore në shtetin italian.

54.3. Sa i takon pasurive të mundshme të krijuara në Itali, subjekti deklaroi se nuk ka pasur automjete apo pasuri të paluajtshme në emër të tij.

54.4. Në lidhje me mënyrën dhe kohën e prurjes në Shqipëri të shumës 60.000 euro, ka deklaruar se është sjellë pjesë-pjesë prej tij dhe i vëllai, dhe duke qenë se, asnjëherë nuk ka kaluar pikën kufitare me një shumë mbi 10.000 euro, këto shuma nuk janë deklaruar.

54.5. Për sa i përket saktësisht të çdo destinacioni përdorimi të shumës prej 60.000 euro, subjekti deklaroi se e ka përdorur atë në Shqipëri për blerjen e pasurisë me nr. ***, z. k. ***, tokë arë me sipërfaqe 1.000 m² dhe për ndërtimin e një impianti gazi në këtë tokë (në total në vlerën 4.200.000 lekë, sipas deklaratës para fillimit të detyrës si OPGJ të datës 13.1.2006, trajtuar në vijim). Siç duket, në pyetësorin nr. 4, subjekti nuk e përmend likuiditetin në shumën prej 60.000 euro si burim për blerjen e pasurisë apartament objekt verifikimi në Vlorë, në kundërshtim me sa ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, shpjegimet e dhëna në ILDKPKI dhe shpjegimet e dhëna në pyetësorin nr. 2.

55. Krahasimisht me DPDFD-në e vitit 2014, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim përveç të ardhurave nga emigracioni edhe ndihmë financiare nga prindërit, qëndrim i mbajtur edhe në sqarimet e dhëna në ILDKPKI më 18.3.2016. Referuar këtij deklarami, gjatë hetimit administrativ nga ana e Komisionit u kryen verifikime në lidhje me mundësitë financiare të

²²Leje qëndrimi në emër të z. Erind Reovica, ku vërehen të dhënat: adresa ***, ***-***; për studime, lëshuar në datën 4.9.1997 dhe e rinovuar në datën 10.04.2000; librezë kursimesh pranë bankës “Sanpaolo” në Itali, çelur në datën 18.6.1998, në emër të z. Erind Reovica, me balancë në këtë datë 1.980.000 lireta; kod fiskal nr. ***, nga zyra e taksave Romë, datë 12.9.1997; llogari rrjedhëse postare për derdhje të shumës 75.000 lireta nga z. Erind Reovica, me adresë: ***; deklaratë dore të shtetasis O.Gj., i cili deklaroi se ka jetuar së bashku me z. Erind Reovica në një dhomë në konviktin “*****” në Romë, në periudhën nga shtatori 1997 deri në fund të vitit 2009 dhe se pas kësaj periudhe kanë marrë një apartament me qira në zonën ***, në rrethinat e Romës, e cila është ndarë dhe me studentë të tjerë; deklaratë (jo noteriale) e shtetasis I.Q., i cili deklaroi se në vitet 1999 dhe 2000 ka bashkëjetuar në një apartament me qira me z. Erind Reovica dhe të tjerë, të cilët kanë ndarë shpenzimet e qirasë dhe shpenzime të tjera të lidhura me ambientet e banimit.

prindërve të subjektit. Konkretisht, u administruan: (i) aktet²³ në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në të cilin subjekti nuk ka dhënë shpjegime dhe as nuk ka vërtetuar me dokumentacion të ardhura të prindërve të tij.

56. Bazuar në provat e administruara, subjekti nuk ka vërtetuar të ardhura të ligjshme nga emigracioni në Itali dhe, për këtë arsye, shuma 60.000 euro nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme e përdorur si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi në O., Vlorë. Gjithashtu, subjekti nuk vërtetoi të ardhura të prindërve për të justifikuar ndihmën e tyre financiare në blerjen e pasurisë.

57. Në përfundim të hetimit administrativ për apartamentin e banimit në Vlorë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën konstatimeve, duket se:

- Referuar rrethanave si vijnë: (i) çmimi i blerjes së pasurisë është 2.9 herë më i lartë se çmimi i referencës; (ii) nga pamjet e jashtme të godinës ku ndodhet pasuria, duket se ambienti i blerë është në pjesën e poshtme të godinës, e cila është me xham dhe e ndarë nga pjesa më sipër që i përket apartamenteve të banimit; (iii) pasuria nuk është përdorur si apartament banimi nga ana e subjektit të rivlerësimit, krijohet dyshimi se subjekti ka porositur/blerë njësi shërbimi dhe jo apartament banimi.

- Ka mospërputhje të deklarimeve të burimit të krijimit të pasurisë në DPFD-në e vitit 2014, ku subjekti ka deklaruar vetëm të ardhura nga emigracioni, dhe deklaratës *Vetting*, ku subjekti ka deklaruar të ardhura nga emigracioni dhe ndihmë financiare nga prindërit.

- Subjekti nuk ka mundur të provojë të ardhura të ligjshme nga emigracioni apo nga prindërit e tij dhe, për këtë arsye, ndodhej në kushtet e pamundësisë financiare për të paguar shumën 34.800 euro/4.822.354 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

58. Sa i takon çmimit të apartamentit, subjekti pretendoi ai është real, i përcaktuar me vullnetin e lirë ndërmjet palëve dhe fakti që vlera e apartamentit është 2,9 herë më e lartë se çmimet e referencës, sipas tij, tregon deklarinimin me vërtetësi të kësaj pasurie dhe burimit të saj. Subjekti mban të njëjtin qëndrim si dhe gjatë hetimit, sipas të cilit, apartamenti nuk është përdorur dhe se nga fotot e paraqitura në parashtrime, duket qartë se kjo pasuri është apartament.

Subjekti nuk ka dhënë shpjegime, në lidhje me dyshimet se kjo pasuri mund të jetë blerë si njësi shërbimi, duke e lënë të paqartë cili ishte shkaku konkret i blerjes së pasurisë rreth tre herë më lart se çmimi referencë. Por, pavarësisht argumenteve të pakta të subjektit të rivlerësimit, referuar fakteve dhe rrethanave, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, në përfundim të procesit nuk u vërtetua që pasuria objekt verifikimi të jetë blerë si një njësi shërbimi dhe, për më tepër, u vërtetua që nuk është përdorur nga ana e subjektit të rivlerësimit.

59. Sa i takon mospërputhjes së deklarimeve të burimit të krijimit të pasurisë në DPFD-në e vitit 2014, ku si burim janë deklaruar vetëm të ardhura nga emigracioni dhe deklaratës *Vetting*, ku si burim janë deklaruar të ardhura nga emigracioni dhe ndihma financiare nga prindërit, subjekti nuk dha sqarime. Në përfundim, nga Komisioni u vlerësua se shtimi i ndihmës financiare nga prindërit si burim në deklaratën *Vetting*, merr një peshë specifike në kushtet kur subjekti nuk ka vërtetuar të ardhura të ligjshme nga emigracioni.

60. Në lidhje me të ardhurat nga emigracioni që kanë shërbyer si burim për krijimin e likujditetit në *cash* prej 60.000 euro, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke lënë të kuptohet se kjo shumë ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Vlorë. Subjekti kërkon që ky likujditet të konsiderohet me të ardhura të ligjshme, duke argumentuar se : “... shuma e përfituar është deklaruar në DPV fillestare por

²³Shihni aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe akte të ndodhura në sistem në adresën qkb.gov.al

edhe në DPV-në e vitit 2005. Në këto kushte ashtu siç arsyetohet edhe në praktikën vendimmarrëse të trupave të rivlerësimit, duke qenë se ato janë realizuar shumë kohë para miratimit dhe hyrjes në fuqi të paketës kushtetuese të Reformës në Drejtësi, duke përfshirë dhe ligjin nr. 84/2016, të cilët përcaktuan rregulla specifike në drejtim të provueshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të siguruara nga subjektet e rivlerësimit, për efekt të kontrollit e verifikimit të pasurive të tyre, rezulton gjithashtu se ato janë krijuar para fillimit të detyrës, standardi i provueshmërisë për këto të ardhura duhet të jetë ai i nxjerrjes së justifikimit bindshëm edhe për një nivel më të ulët të provave, sesa do të duhej për të kënaqur standardin e provueshmërisë për pasuritë e vëna gjatë ushtrimit të detyrës apo periudhës së rivlerësimit...”.

Siç vërehet, në parashtrimet e tij, subjekti ka mbajtur qëndrimin përfundimtar se shuma 60.000 euro ka shërbyer për blerjen e pasurisë objekt verifikimi. Ndërsa, në seancën dëgjimore përfaqësuesja ligjore e tij ka deklaruar se shuma 60.000 euro është përdorur për: (i) blerjen e apartamentit objekt verifikimi në Vlorë; (ii) krijimin e gjendjes *cash* prej 1.000.000 lekësh (pjesë përberese e likuiditetit në *cash* prej 1.500.000 lekësh deklaruar në deklaratën *Vetting*); dhe (iii) shumën 1.000.000 lekë për shpenzimin e kryer në vitin 2013, për pagesën e përmbaruesit²⁴. Sipas saj, edhe shuma prej 4.200.000 lekësh për blerjen e pasurisë tokë arë plus investimi prej 200.000 lekësh, deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës si OPGJ të datës 13.1.2006, ka qenë me burim nga emigracioni, duke lënë të kuptohet se para vitit 2005, subjekti përveç likuiditetit 60.000 euro ka pasur dhe një likuiditet prej 4.200.000 lekësh me burim të ardhura nga emigracioni.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se deklarimi i përfaqësueses A.S., për sa i takon përdorimit të shumës 60.000 euro, duket se qëndron, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës si OPGJ të datës 13.1.2006, subjekti ka deklaruar blerjen e tokës dhe ndërtimin e objektit për impiant gazi, në total në shumën 4.200.000 lekë dhe gjendjen *cash* prej 60.000 euro, çka do të thotë se kjo shumë ka mbetur si gjendje në fund të dhjetorit të vitit 2005, pas shpenzimit prej 4.200.000 lekësh përdorur për blerjen e tokës dhe ndërtimin e objektit.

Pra referuar deklarimeve të tij, para fillimit të detyrës si OPGJ në Dhjetor të vitit 2005, subjekti ka pasur likuiditetin në *cash* prej 60.000 euro plus shumën 4.200.000 lekë, të dyja me burim të pretenduar nga emigracioni në Itali, ndërkohë që, të ardhurat e deklaruara prej tij me burim emigracionin në Itali në deklaratën para fillimit të detyrës si OPGJ të datës 13.1.2006, janë vetëm në shumën 30.000 euro.

61. Sa i takon të ardhurave të siguruara në emigracion në parashtrimet e tij, subjekti nuk ka paraqitur deklarime e dokumente shitesë të ndryshme nga ato të paraqitura gjatë hetimit administrativ, por i referohet shumës 2.000.000 lireta/muaj, përfituar nga punësimi pranë shoqërisë “P.” s.r.l., shumë të cilën e kishte pretenduar edhe gjatë hetimit administrativ. Subjekti ka paraqitur një *e-mail* të dërguar nga shtetasja B.B. administratore e shoqërisë “P.” s.r.l., bashkëngjitur shkresën me datë 1.2.2022, me të cilat konfirmohet se subjekti ka qenë i punësuar në vitet 1997 – 2000 në shoqërinë e saj, por nuk ka paguar detyrimet tatimore, për shkak se në atë kohë ishte student dhe nuk mund të punësohej ligjërisht sipas rregullave. Sipas subjektit, pagesa e detyrimeve tatimore nuk ka qenë detyrim i tij, por përgjegjësi dhe detyrim i punëdhënësit, si dhe mban qëndrimin se nuk mund të dëmtohet e të ketë përgjegjësi disiplinore në vitin 2022, për detyrime të papaguara tatimore nga punëdhënësi i tij në Itali 25 vjet më parë.

Sa i takon pretendimit të znj. B.B. se detyrimet tatimore nuk janë paguar, për shkak se subjekti ka qenë student dhe nuk mund të punësohej rregullisht sipas ligjit, referuar dekretit të Presidentit të Republikës së Italisë, datë 31.8.1999, nr. 394, neni 14, paragrafi 4, leja e

²⁴Trajtuar në paragrafin 99 të këtij vendimi.

qëndrimin në Itali për qëllime studimi lejon punësimin për një kohë jo më tepër se 20 orë/javë, por ky fakt, nuk përjashton pagesën e detyrimeve tatimore ndaj shtetit.

62. Lidhur me të ardhurat nga emigracioni, duke pretenduar se ato pa të drejte nuk janë marrë në konsideratë si të ligjshme, subjekti ka sjellë në vëmendje qëndrimin zyrtar të mbajtur nga përfaqësuesi i ONM-së, z. F.B.M., ndaj vendimit nr. 06, datë 28.2.2019 të Kolegjit, sa i takon parashikimeve të nenit D të Kushtetutës dhe neneve 31, 32, 61 dhe 62 të ligjit nr. 84/2016, që sipas tij, është pasqyruar në vendimin nr. ***, datë 3.12.2021, të Komisionit²⁵.

Sa i takon opinionit të ONM-së, të cilit përfaqësuesja e subjektit iu referua edhe në seancë dëgjimore, Komisioni vëren se vëzhguesi ndërkombëtar ka paraqitur mendimin e tij ndaj vendimit nr. 06, datë 28.2.2019 të Kolegjit, duke arsyetuar mbi fakte e rrethana konkrete të kësaj çështjeje. Në këto kushte, ai nuk çmohet si i barasvlershëm me një opinion të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar për çështjen e subjektit Erind Reovica, për sa kohë nuk ka një rekomandim/opinion për këtë subjekt sipas pikës 11 të nenit 49 të ligjit 84/2016 dhe, për pasojë, nuk mund të shërbejë si orjentim vlerësimi konkret për këtë subjekt.

63. Megjithatë, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, herë pas here të ndryshme, kontradiktore dhe jo të logjikshme me rrethanat dhe deklaratat e paraqitura prej tij, trupa gjyqësore vlerësoi se në rastin e subjektit Reovica, Komisioni nuk ndodhet në pozita të ngjashme me rastin e sjellë në vëmendje të trajtuar nga KPK dhe as në kushtet e parashtruara në opinionin e ONM-së në lidhje me vendimin nr. 06, datë 28.2.2019, pasi të ardhurat e pretenduara nga emigracioni mbeten tërësisht në kuadër deklarativ, për arsye se:

i) Në ushtrim të barrës së provës, subjekti paraqiti një dokument shkresor me të cilin pretendon të vërtetojë punësimimin e tij pranë shoqërisë “P.” s.r.l., në Itali, ku ka fituar 2.000.000 lireta/muaj, për periudhën shtator 1997 – 2000, e cila është periudha e qëndrimit të tij në Itali. Ky punësim mbetet në nivel deklarativ, pasi vërtetohet me një deklaratë të thjeshtë të znj. B.B. e përpiluar me shkrim shtypi, ndërsa, data 8.11.2021, që shkresa mban është shënuar me shkrim dore. Kjo deklaratë duket se nuk është një dokument zyrtar për shkak të mënyrës së paraqitjes së të dhënave dhe mungesës së legalizimit të aktit në formën e kërkuar nga ligji.

ii) Fakti që subjekti ka qenë me studime në Itali nuk mund ta ketë lejuar të punojë me kohë të plotë, në mënyrë që të përfitonte shumën 2.000.000 lireta/muaj. Por, edhe në rast se do të merrej e mirëqenë se subjekti ka përfituar të ardhura prej 2.000.000 lireta/muaj, për periudhën shtator 1997 deri shtator 2000 sikurse pretendon, shuma e të ardhurave të akumuluar do të ishte në vlerën 74.000.000 lireta ose 38.218 euro²⁶, shumë së cilës nëse do t'i zbrisim shpenzime jetese në vlerën 16.649 euro²⁷, do të shkonte në 21.569 euro, një shumë e pamjaftueshme për të krijuar kursime në vlerën 60.000 euro (likuiditeti i deklaruar në DPFDF-në e vitit 2005) plus shumën 4.200.000 lekë (vlera e truallit të blerë në vitin 2005 dhe objektit të planifikuar për impiant gaz, deklaruar në DPFDF-në e vitit 2005).

iii) Në një vlerësim të të gjitha provave dhe fakteve dhe sidomos referuar periudhës së shkurtër prej tre vite qëndrimi në Itali të subjektit si student, pretendimet e tij për të ardhura në emigracion në shumën totale 95.000 euro²⁸, bëhen të pabesueshme. Për më tepër, vetë subjekti në DPFDF-në e vitit 2005, ka deklaruar si të ardhura nga emigracioni vetëm vlerën 30.000 euro,

²⁵Ky vendim nuk ka marrë formë të prerë.

²⁶Kursi i këmbimit 1 euro = 1.936 lireta.

²⁷Shihni të dhënat tek Eurostat-i për periudhën 1997 – 2000

https://stats.oecd.org/index.aspx?DataSetCode=AV_AN_WAGE#

²⁸Kjo shumë përbëhet nga kursimet e deklaruara në DPFDF-në e vitit 2005: *cash* 60.000 euro dhe 4.200.000 lekë e investuar në impiantin e gazit në Shqipëri në vitin 2005.

e cila është e përafërt me të ardhurat e pretenduara të punësimit në shoqërinë “P.” s.r.l., në Itali, në total prej 38.218 euro.

64. Në konkluzion të gjithë sa më sipër, sa i takon mospërputhjes së deklaramit të burimit të krijimit të pasurisë objekt verifikimi në DPV-në e vitit 2014 me deklaratën *Vetting*, si dhe mungesës së të ardhurave të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve të Komisionit. Pavarësisht se pasuria në O., Vlorë, është blerë me të ardhura përpara fillimit të detyrës, ajo është një pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit 84/2016, subjekti duhet të vërtetonte burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e saj. Është e vërtetë që për shkak të periudhës kur pretendohet se janë krijuar të ardhurat në emigracion, Komisioni nuk mund të penalizojë subjektet në rastin e pamundësisë objektive të vërtetimit të pagimit të detyrimeve tatimore mbi të ardhurat, sipas nenit 31/2 të ligjit 84/2016, por, nga ana tjetër, Komisioni nuk mund të anashkalojë faktin se subjekti nuk vërtetoi të ardhura në emigracion të cilat do të kishin mundësuar blerjen e pasurisë objekt verifikimi. Të ardhurat në shumën 30.000 euro deklaruar në DPFD-në e vitit 2005 me burim emigracionin, përveç se mbeten në nivel deklarativ, nuk justifikojnë likuiditetin në *cash* në shumën 60.000 euro, deklaruar po në këtë deklaratë, çka e bën të dyshimtë faktin që kjo shumë të ketë ekzistuar vërtetë dhe të jetë mbartur deri në vitin 2011-2012, kur u porosit/ble pasuria objekt verifikimi. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe subjekti ka qenë OPGJ, një detyrë funksionale ndihmëse e organeve të drejtësisë. Gjithashtu, ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti ka shtuar si burim ndihmesën familjare, fakt që merr një peshë specifike në kushtet e mungesës së të ardhurave nga emigracioni deklaruar si burim i vetëm i pasurisë në DPFD-në e vitit 2014. Për shkak të këtyre fakteve e rrethanave, Komisioni çmoi se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore apo që nuk përputhen me realitetin pikërisht për shkak të mosjustifikimit të blerjes së pasurisë me të ardhura nga emigracioni, të cilat e vënë atë në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarime si dhe ekzistencës së elementëve që çënojnë besimin e tij te publiku si pjese e sistemit të drejtësisë, parashikuar perkatësisht në pikat 3 dhe 5 të nenit 61, të ligjit 84/2016.

65. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Lekë cash, gjendje në banesë 1.500.000 lekë nga këto 500.000 lekë nga shitja e tokës në fshatin Gj. Tiranë dhe 1.000.000 lekë të kursyera nga emigrimi në Itali. Vlera: 1.500 lekë (një milion e gjysmë). Pjesa takuese: 100 %*”. Në lidhje me këtë likuiditet, ILDKPKI-ja ka konstatuar: “*Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e gjendjes cash në shumën 1.000.000 lekë nga emigracioni në Itali. Toka me sip. 1000 m², në Gj., Tiranë, është blerë në vitin 2005, në shumën 4.000.000 lekë dhe është shitur në vitin 2006, në vlerën 500.000 lekë. Është e paqartë pasuria e deklaruar në DPFD-në e vitit 2005, ndërtim objekt i papërfunduar, 100 m², impiant gazi, ku subjekti është aksionar në 50% së bashku me B., duke pasur parasysh faktin se subjekti ka marrëdhënie të vijueshme interesi me B.E. Është e paqartë gjendja cash prej 3.000.000 lekësh deklaruar nga bashkëshortja në DPFD-në e vitit 2014, pasi deklarimi në vijim nuk ka ndryshim të saj dhe në deklaramin *Vetting* deklarohet gjendje cash vetëm nga subjekti në shumën 1.500.000 lekë*”.

Subjekti e ka deklaruar likuiditetin *cash* në shumën 1.500.000 lekë në DPFD-në e vitit 2014, me të njëjtin burim si në deklaratën *Vetting*.

Analizë specifike e dy burimeve të deklaruara për krijimin e likuiditetit në shumën 1.500.000 lekë

66. Sa i takon burimit të shumës 500.000 lekë, përfituar nga shitja e tokës në fshatin Gj., Tiranë, nga aktet në dosje²⁹, rezultoi se:

66.1 Me kontratë shitblerje nr. ***, datë 22.6.2006, subjekti i ka shitur shtetasit L.Z., pasurinë nr. ***, të llojit “arë”, me sip. 1000 m², ndodhur në Gj., Tiranë, në shumën 500.000 lekë, likuiduar para përpilimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale. Sipas shënimit në kartelën e pasurisë, subjekti e ka përfituar këtë pasuri me kontratë shitje në shumën 4.000.000 lekë. Nuk ka kontratë që vërteton blerjen e kësaj pasurie në çmimin 4.000.000 lekë, por në deklaratën para fillimit të detyrës si OPGJ të datës 13.1.2006, subjekti e ka deklaruar: “*Sipërfaqe toke 1000 m², ndodhur në Y., Tiranë, blerë në shumën 4.000.000 lekë dhe pjesën takuese 100%, ndërtim objekti i papërfunduar 100 m², në vlerën 200.000 lekë, në pjesë takuese 50 % në vitin 2005; në këtë objekt do të ngrihet impiant gazi, veprimtari tregtare, e cila është në regjistrim e sipër në gjykatë ku jam aksionar me 50 % së bashku me B. (nuk është shënuar mbiemri i shtetasit me emrin”B.”). Impianti i gazit është drejt përfundimit*”. Nuk është deklaruar sipas ligjit burimi i krijimit të kësaj pasurie.

Siç vërehet, pasuria është shitur pas një viti në vlerën 500.000 lekë, pra, tetë herë më lirë nga çmimi i blerjes. I pyetur gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti deklaroi se toka “arë”, e blerë në çmimin 4.000.000 lekë është shitur pas një viti në vlerën 500.000 lekë, për shkak se u prishën planet për ndërtimin e impiantit dhe krijimit të një biznesi.

66.2. Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 4.200.000 lekë, me të cilën ishte blerë pasuria e shitur në shumën 500.000 lekë, i pyetur nga ILDKPKI-ja³⁰, subjekti në shpjegimet e dhëna sipas procesverbaleve të datave 27.1.2016 dhe 18.3.2016, ka deklaruar se: “*Si burim kanë shërbyer të ardhurat nga emigracioni në Romë, për periudhën 1997 – 2000, ku ka punuar në të zezë dhe se nuk mund të paraqesë dokumentacion për vërtetimin e të ardhurave. Ndërsa objekti me sip. 100 m² do të ngrihej nga ai, por nuk u përfundua për arsye të ndryshme*”, qëndrim i mbajtur edhe gjatë procesit të rivlerësimit.

66.3. Kjo pasuri është shitur në vlerën 500.000 lekë në vitin 2006 dhe, sipas deklarimeve të subjektit, kjo shumë është mbartur si gjendje *cash* deri para fillimit të detyrës në DPDFD në vitin 2014, ashtu sikurse edhe në deklaratën *Vetting*. Duke qenë se nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme nga emigracioni në Itali, mbetet e pajustificuar ligjërisht shuma 4.000.000 lekë, shpenzuar për blerjen e pasurisë. Për pasojë, edhe shuma prej 500.000 lekësh, e përfituar nga shitja e saj, nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të kryer në përfundim të hetimit administrativ.

67. Sa i takon burimit gjendje/likuiditet *cash* në shumën 1.000.000 lekë, rezultoi se:

67.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se ky likuiditet është me të ardhura të kursyera nga emigrimi në Itali. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar në mënyrë kontradiktore se likuiditeti *cash* prej 1.000.000 lekësh është krijuar nga shitja e tokës në Gj., Tiranë dhe nga kursimet e pagës si oficer.

67.2. Referuar burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting*, nuk janë vërtetuar të ardhura nga emigracioni në Itali. Ndërsa, në rast se do të merrej në konsideratë deklarimi në pyetësorin nr. 2, sipas të cilit si burim për krijimin e shumës *cash* prej 1.000.000 lekësh kanë shërbyer të ardhurat nga puna e tij si OPGJ, përsëri këto kursime nga paga nuk do të mund të shërbenin për krijimin e gjendjes *cash*, pasi ato kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 20.000 euro, të depozituar në datën 4.7.2014 në “Raiffeisen Bank” (trajtuar në paragrafin 84 e vijuesës). Ndërsa

²⁹Shihni aneks nr. *** në dosjen ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2020 të ASHK-së; shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2021, të ILDKPK-së, në dosjen e Komisionit.

³⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2021, në dosjen e Komisionit.

sa i takon të ardhurave nga shitja e tokës në Gj., Tiranë, subjekti i kishte deklaruar këto të ardhura si burim për pjesën tjetër të likuiditetit prej 500.000 lekësh, trajtuar në paragrafin 66.

67.3. Nga sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar kursime në shumën 1.000.000 lekë. Por, deri sa shuma 1.000.000 lekë mbartet nga DPFJ-ja e vitit 2014 deri në deklaratën *Vetting*, ajo është e përfshirë në analizën financiare të vitit 2014, nga e cila ka rezultuar se subjekti është në pamundësi për ta krijuar këtë likuiditet në gjendje *cash*, sikurse tregohet në tabelën vijuese.

<i>Përshkrimi</i>	<i>Periudha 20.6.2014–31.12.2014</i>
Pasuritë	4 104 636
Depozituar shuma 20.000 euro	2 802 800
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	<i>1 301 836</i>
Gjendja e likuiditeteve (bankë dhe <i>cash</i>)	4 592 998
Të ardhurat	638 235
Të ardhura nga paga e subjektit	403 083
Paga e bashkëshortes	240 935
Fitimi/humbja nga noteria bashkëshortja	-5 783
Nga shitja e tokës arë në vitin 2005	0
Shpenzimet	1 949 907
Shpenzime jetese	211 536
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	184 191
Shpenzime transporti	54 180
Sistemim veprimi për burimin e paligjshëm për gjendjen	1 500 000
Mundësia për kursime	-5 416 308

68. Në lidhje me veprimtarinë tregtare-impianit gazi, referuar deklaratimeve në DPFJ-në si OPGJ plotësuar e dorëzuar në janar të vitit 2006, subjekti është pyetur nga Komisioni se për çfarë shoqëri tregtare bëhet fjalë dhe i është kërkuar informacion për historikun e saj, nëse ka qenë aksionar/ortak ose jo, të shpjegonte mënyrën e largimit nga kompania, si dhe të japë sqarime në lidhje me shtetasin “B.”, të cilin ai e ka përmendur në këtë deklaratë. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se regjistrimi në gjykatë i shoqërisë nuk u realizua për arsye se hoqi dorë dhe impianti i gazit nuk u përfundua dhe se nuk ka qenë aksionar në asnjë aktivitet biznesi. Në lidhje me shtetasin “B.” deklaroi se nuk i kujtohet mbiemri. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka deklaruar në mënyrë kontradiktore se: *“Dua të saktësoj se në pyetësorin nr. 2, pyetja nr. 6 jam përgjigjur se nuk e kam realizuar regjistrimin e shoqërisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë se hoqëm dorë, faktikisht pasi kam bërë kërkimet në lidhje me këtë regjistrim (me dokumentacionin e së cilës nuk jam marrë personalisht) dua të saktësoj se shoqëria është regjistruar, por nuk ka funksionuar asnjëherë, për shkak të mosmarrëveshjeve që kishim ne aksionaret me njeri - tjetrin dhe kemi hequr dorë nga ky biznes”*. Por, nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor për të vërtetuar këto fakte.

Nga verifikimet e kryera në faqen e QKB-së nuk ka të dhëna për subjektin e rivlerësimit apo shoqëri të regjistruar në emër të tij.

69. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës si vijon:

- Në lidhje me likuiditetin *cash* prej 1.500.000 lekësh, duket se: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtij likuiditeti; (ii) ka mospërputhje në deklaratime në lidhje me burimet e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pjesës përbërëse të likuiditetit *cash* në shumën prej 1.000.000 lekësh, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti ka

deklaruar të ardhura të kursyera nga emigrimi në Itali, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar të ardhura nga shitja e tokës në Gj., Tiranë dhe nga kursimet e pagës si oficer.

- Në lidhje me aktivitetin për impiantin e gazit, mbeten të paqarta faktet: (i) kur është regjistruar në gjykatë shoqëria për të cilën subjekti ka kryer deklarime në DPDFD-në si OPGJ në vitin 2005 dhe në përgjigje të pyetësorit katër; (ii) cilët kanë qenë aksionarët dhe sa përqind të aksioneve ka pasur subjekti në këtë shoqëri; (iii) cili është statusi aktual i shoqërisë dhe nëse është mbyllur aktiviteti tregtar, në çfarë periudhe; (iv) cili ka qenë pozicioni/statusi/përqindja e fitimit të subjektit në këtë shoqëri. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

- Subjektit i është kërkuar të japë sqarime e të paraqesë dokumente shkresore në lidhje me secilin prej konstatimeve të sipërpërmendura, si dhe të vërtetojë që nuk ka kryer veprimtari private në kundërshtim me ushtrimin e detyrës si prokuror, sipas parashikimit të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, urdhrit³¹ nr. ***, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”; ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit, bazuar në provat e administruara dhe në ligjin e zbatueshëm

70. Në lidhje me paqartësitë sa i takon shoqërisë që kishte lidhje me veprimtarinë e impiantit të gazit, subjekti deklaroi se nuk ka arritur të gjejë dokumentacion, duke dhënë të njëjtat shpjegime si gjatë procesit të hetimit, sipas të cilave kjo shoqëri nuk ka funksionuar asnjëherë sepse ai filloi punë si OPGJ. Sipas tij, ai sikurse dhe Komisioni, ka marrë të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe ka kryer verifikimin *online*, në faqen e QKB-së dhe nuk ka rezultuar se zotëron kuota apo aksione në ndonjë shoqëri tregtare. Subjekti paraqiti bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2022, nga Drejtoria Rajonale Berat, e cila ka përcjellë historikun e punësimit të subjektit, pasi është emëruar në detyrën e prokurorit në vitin 2014, me punëdhënës Prokuroritë e Krimeve të Rënda të Rretheve Vlorë dhe Fier.

71. Siç vërehet, subjekti vijon të deklarojë se shoqëria nuk ka funksionuar asnjëherë, pa deklaruar fakte në lidhje me regjistrimin e saj. Por, referuar rrethanave si vijojnë:

i) deklarin në DPDFD-në si OPGJ në vitin 2005 *se: ... në këtë objekt do të ngrihet impiant gazi veprimtari tregtare, i cilit është në regjistrim e sipër në gjykatë në të cilin jam aksionar me 50 % së bashku me B.;*

ii) deklarin në pyetësorin nr. 4, *se: ... faktikisht pasi kam bërë kërkimet në lidhje me këtë regjistrim (me dokumentacionin e të cilit nuk jam marrë personalisht) dua të saktësoj se shoqëria është regjistruar, por nuk ka funksionuar asnjëherë, për shkak të mosmarrëveshjeve që kishim ne aksionarët me njeri - tjetrin dhe kemi hequr dorë nga ky biznes;*

iii) deklarin në pyetësorin nr. 4, në lidhje me dy transferta në emër të shtetasit Z.M. në vitin 2013 *se: ... Shumat me vlerën prej 911.500 lekësh dhe shuma në vlerën prej 1.000.000 lekësh janë shuma të cilat janë të transferuara në llogari të shtetasit Z.M. (i cili ka qenë përmbarues) dhe këto shuma kanë shërbyer për pagimin e detyrimeve të mia kundrejt aksionares tjetër të shoqërisë që doja të krijoja, shuma të cilat ajo i pretendonte karshi mej....*

³¹Neni 4, pika 1 parashikon: “Prokurorët në ushtrimin me pavarësi të funksioneve apo detyrave të tyre, duhet që: ç) Të mos zhvillojnë veprimtari ekonomike, përfshirë çdo lloj pune apo biznes për të përfituar interesa materiale ose jomateriale, që mund të ndikojnë në pavarësinë e tyre ose që mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tyre ose personave të tjerë, si dhe nuk duhet të anëtarësohen në organizata shoqërore, të cilat krijojnë dyshimin se komprometojnë figurën e prokurorit apo janë të papajtueshme me funksionin e tij”.

ka të dhëna që subjekti e persona të tjerë kishin vendosur të krijonin një shoqëri, e cila ka kaluar në procedura regjistrimi e më pas, është hequr dorë nga kjo shoqëri. Por, subjekti në parashtrimet e veta, mungon të ketë dhënë shpjegime në lidhje me periudhën e procedura të regjistrimit, ortakët e shoqërisë, pjesëmarrjen në kapitalin e saj, periudhën e çregjistrimit të saj, personin me emrin "B.", duke u mjaftuar vetëm me deklarimin se kjo shoqëri nuk ka funksionar asnjëherë. Për më tepër, nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor, si dhe nuk ka bërë asnjë përpjekje për kërkim të dhënash pranë çdo institucioni ligjor kompetent pranë të cilit është regjistruar shoqëria, po ashtu edhe pranë ndonjë individi, i cili ka qenë ortak/administrator i shoqërisë dhe që është marrë me procedura të regjistrimit/çregjistrimit të shoqërisë, sikurse vetë ka deklaruar. Ndërkohë, shkresa nr. *** prot., datë 27.1.2022, nga Drejtoria Rajonale Berat, është lëshuar në përgjigje të kërkesës së subjektit me nr. *** prot., datë 25.1.2022, i cili ka kërkuar informacion nëse nga data 20.6.2014, kur ka filluar detyrën e prokurorit, e në vazhdim, ka pasur person fizik, juridik, ku ai të ketë kryer veprimtari private (administrator, ortak dhe aksioner). Kjo shkresë ka vërtetuar historikun e punësimit të subjektit, pasi është emëruar në detyrë më 20.6.2014, me punëdhënëse Prokuroritë e Krimeve të Rënda, të Rrethit Vlorë dhe Fier, pa dhënë informacion në lidhje me ndonjë aktivitet privat, ku subjekti ka qenë ortak apo administrator i ndonjë shoqërie tregtare, përpara kësaj periudhe.

Pavarësisht sa më sipër, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin se subjekti ka ushtruar veprimtari në kundërshtim me ligjin. Por, sjellja e subjektit i cili nuk ka dhënë shpjegime e dokumente shkresore për të qartësuar Komisionin në lidhje me sa i është kërkuar me kalimin e barrës së provës, së bashku me rrethana të tjera të evidentuara në vendim si: ndryshimin e deklarimeve në lidhje me regjistrimin e shoqërisë tregtare, si dhe mungesën e deklarimeve për identitetin e shtetasit me emrin "B.", vlerësohen në kuadër të sjelljeve që ndikojnë në cenimin e besimit të publikut të personi i tij pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë.

72. Sa i takon likuiditetit *cash* prej 1.500.000 lekësh, deklaruar në deklaratën *Vetting*, subjekti ka parashtruar se e ka pasur këtë shumë në shtëpi përpara fillimit të detyrës si prokuror dhe se Komisioni pa të drejtë e ka konsideruar me të ardhura të paligjshme duke vijuar të argumentojë se mungesa e të dhënave për të ardhura nga emigracioni nuk mund të bëhet shkak për penalizim të tij.

73. Sa i takon mospërputhjes në deklaratimet e burimit të likuiditetit *cash* prej 1.000.000 lekësh, subjekti ka sqaruar se ka qenë pakujdesi nga ana e tij deklarimi gjatë hetimit administrativ sipas të cilit si burim kanë shërbyer të ardhurat nga puna e oficerit të policisë gjyqësore (në përgjigje të pyetësorit nr. 4 ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna e oficerit të policisë gjyqësore si dhe të ardhurat nga shitja e tokës në Gj., Tiranë), pasi sipas tij kjo gjendje *cash* është krijuar me të ardhurat nga emigracioni, ashtu siç është deklaruar në të dyja deklaratat (nënkupton DPFD-në e vitit 2014 dhe deklaratën *Vetting*). Siç vërehet, subjekti, në parashtrimet e veta ka ndryshuar përsëri thëniet. Po kështu, sipas tij, edhe shuma 500.000 lekë, e cila ka si burim shitjen e tokës me sip. 1000 m², në Gj., Tiranë, nuk duhet të konsiderohet si e ardhur e paligjshme, për shkak se edhe kjo shumë ka si burim të ardhurat nga emigracioni, të krijuara dhe të materializuara përpara fillimit të detyrës, madje përpara fillimit të punës edhe si OPGJ.

74. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, është e vërtetë se burimi i likuiditetit në *cash* prej 1.500.000 lekë është deklaruar me të ardhura nga emigracioni, pra, përpara se subjekti të fillonte detyrën e prokurorit. Por, duke qenë se ky likuiditet është mbartur që nga viti 2005 apo 2006 kur u shit pasuria në Gj. Tiranë, deri në vitin 2014 (vite në të cilat subjekti ka qenë OPGj), si dhe në vijim, deri në deklaratën *Vetting*, për të hequr çdo dyshim që ky likuiditet mund të jetë krijuar me të ardhura të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës dhe sipas parashikimeve të pikës 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti duhet të vërtetonte burimin e ligjshëm të të ardhurave. Në kushtet, kur subjekti nuk e përmbushi këtë

detyrim, shuma prej 1.500.000 lekësh, nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën përfundimtare financiare.

75. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi se subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës në lidhje me likuiditetin me vlerë 1.500.000 lekë, si dhe është në kushtet e deklarimeve kontradiktore në lidhje me burimin e të ardhurave. Për rrjedhojë, ka kryer deklarime të pamjaftueshme duke qenë në kushtet e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

76. Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën përshkrimi i detyrimeve, subjekti ka deklaruar: *“Kontratë huaje me huamarrës B.E., i cili i ka investuar për rikonstruksion hotel ‘P.’, Berat dhe me këtë person kam lidhje shoqërore. Shuma, e cila është dhënë hua, është përfituar si oficer i policisë gjyqësore dhe ndihmë financiare nga prindërit. Shuma e detyrimit: 17.000 euro”*. Në lidhje me këtë hua, ILDKPKI-ja ka konstatuar se subjekti është i pasaktë dhe i paqartë në lidhje me huan e dhënë B.E. Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për burimin e krijimit të shumës 17.000 euro, si ndihmë financiare nga prindërit dhe nuk ka përcaktuar shumën e dhënë nga ata.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë hua

77. Sipas kontratës së huas (jonoteriale) të datës 15.2.2015, të lidhur mes palëve Erind Reovica, si huadhënës dhe B.E. si huamarrës, subjekti i jep huamarrësit shumën prej 17.000 euro, pa afat dhe pa interes. Në këtë kontratë nuk është përcaktuar qëllimi i shumës së marrë hua nga huamarrësi, ndërsa në deklaratën *Vetting* është deklaruar se kjo shumë është investuar për rikonstruksion të hotelit “P.” në Berat.

78. Nga verifikimi i deklaratave periodike është evidentuar se:

- Në DPV-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar: *“Detyrim nga shtetasi B.E. kundrejt huadhënies 18.000 euro, tërhequr nga depozita pranë ‘Raiffeisen Bank’. Vlera: 2.000 euro kursime nga paga. Gjendja e detyrimit: 20.000 euro”*.

- Në DPV-në e vitit 2015 në rubrikën “Të dhëna konfidenciale, dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar: *“Nga llogaria bankare e ‘Raiffeisen Bank’ huadhënies shtetasi B.E. Nga shuma 20.000 euro mbetur është 3.700 euro, 16.700 huadhënie”*.

- Në DPV-në e vitit 2016 në rubrikën “Të dhëna konfidenciale në lidhje me pasurinë”, subjekti ka deklaruar: *“Kontratë huaje me huamarrës B.E. Shuma, e cila është dhënë hua, është përfituar nga kursimet si oficer i policisë gjyqësore dhe ndihmë financiare nga prindërit. 17.000 euro”*.

79. Siç vërehet në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka shtuar si burim edhe ndihmën financiare nga prindërit. Për shkak të mospërputhjeve në deklarime sa i takon vlerës së huas dhe burimit që kanë shërbyer për këtë hua, u pyet subjekti të saktësojë: (i) shumën e huas dhënë shtetasit B.E.; (ii) burimin e saj duke specifikuar sa është nga kursimet e pagave si OPGj dhe sa nga ndihma financiare nga prindërit e tij. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se me shtetasin B.E. ka lidhur kontratën e huas prej 17.000 euro, shumë e tërhequr nga llogaria bankare në “Raiffeisen Bank”, krijuar nga kursimet e pagës nga viti 2005 deri në vitin 2014, si dhe ka paraqitur lëvizjet e llogarisë në “Raiffeisen Bank”, ku është pasqyruar veprimi i tërheqjes së shumës 16.700 euro. Ndërsa, sa i takon burimeve të deklaruara në deklaratën *Vetting* dhe DPV-në e vitit 2016, konkretisht shumës së paguar nga subjekti dhe shumës së dhënë nga prindërit si ndihmë financiare, si dhe mospërputhjeve në deklarime, subjekti nuk ka dhënë asnjë sqarim.

80. Në lidhje me qëllimin e dhënies së huas në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se huaja është investuar nga huamarrësi, për rikonstruksion të hotel “P.”, Berat. Për të hequr çdo dyshim të mundshëm sa i takon përfshirjes së subjektit në një biznes me shtetasin B.E., Komisioni i kërkoi subjektit të jepte sqarime në lidhje me biznesin hotel “P.”, për formën e tij juridike dhe aksionerët në këtë biznes. Nga sqarimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të

pyetësorit nr. 2, si dhe nga dokumentet e paraqitura prej tij³², nuk u vërtetuan të dhëna në lidhje me këtë biznes. Nga verifikimi i faqes elektronike të QKB-së nga ana e Komisionit, nuk rezultoi të ishte i regjistruar ndonjë biznes hotel “P.”, Berat, me objekt hoteleri. Në këto rrethana, mbetet i paqartë deklarimi në deklaratën *Vetting*, në lidhje me qëllimin e huamarrjes.

81. Sa i takon konfliktit të interesit dhe përfshirjes në veprimtari kriminale³³ të shtetasit B.E., Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Fier, ku subjekti ka ushtruar detyrën, nuk konfirmuan kallëzime/procedime penale të hetuara nga subjekti për shtetasin B.E. Po kështu, pas kërkesës së Komisionit, SPAK nuk ka konfirmuar procedime penale të regjistruara në emër të tij. Gjithashtu, me kërkesë të Komisionit, Prokuroria e Përgjithshme³⁴ ka përcjellë informacionin e dërguar nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve, të cilat nuk konfirmuan kallëzime/procedime penale ndaj shtetasit B.E.

82. Sa i takon shlyerjes së kësaj huaje, subjekti ka paraqitur një deklaratë dore të bashkëshortes së huamarrësit, znj. E.G.³⁵, sipas së cilës rezulton se huaja në shumën 17.000 euro nuk është shlyer ende.

83. Për të verifikuar deklaratimet e subjektit, në lidhje huan objekt verifikimi si dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shumën e dhëne hua, Komisioni mori në shqyrtim aktet në dosje³⁶ dhe në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se:

- Sipas informacionit të dhënë nga DPPPP-ja³⁷ rezultoi se: (i) në datën 4.7.2014 subjekti ka kryer veprimin derdhje në shumën 20.000 euro, në llogari “Raiffeisen Bank; (ii) në datën 5.2.2015 subjekti ka kryer veprimin tërheqje nga llogaria me kartë, në shumën 16.700 euro.

- Në DPFD-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *“Llogari bankare në ‘Raiffeisen Bank’ nga kursimet e pagës si oficer i policisë gjyqësore për përdhën 9 vjet e 6 muaj, shuma 20.000 euro, pjesa në % 100%”*.

- Nga lëvizjet e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”³⁸ është evidentuar se në datën 4.7.2014 subjekti ka depozituar *cash* shumën 20.000 euro. Në këtë datë është çelur një depozitë me afat 6 muaj, në shumën 16.700 euro, e cila është maturuar në datën 5.1.2015³⁹ dhe në datën 15.2.2015, kjo shume është tërhequr nga ana e subjektit. Në të njëjtën datë, 15.2.2015, është nënshkruar kontrata e huas, në lidhje me të cilën subjekti ka kryer deklarime që në DPV të vitit 2014, çka të krijon bindjen se kjo shumë e tërhequr nga “Raiffeisen Bank” ka shërbyer për dhënien e huas prej 17.000 euro te shtetasi B.E.

84. Sa i takon mundësisë së subjektit për të krijuar depozitën prej 20.000 euro nga kursimet e tij ndër vite nga paga si OPGJ, Komisioni ka kryer analizën financiare të treguar në tabelën më poshtë, sipas së cilës, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë shumë.

³²Subjekti paraqiti dokumentet shkresore: ekstrakt historik të “E.G.”, person fizik, me NUIS ***; certifikatë vdekjeje të shtetasit B.E.; certifikatë martesë; deklaratë jonoteriale të znj. E.G.

³³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresën nr. *** prot., datë 19.10.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

³⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.11.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, bashkëngjitur informacionin e përcjellë nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve.

³⁵Shtetasi B.E. ka ndërruar jetë në datën 13.10.2019, sipas certifikatës së vdekjes paraqitur nga subjekti me pyetësorin nr. 2.

³⁶Shihni aneks nr. *** dhe nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe dokumentet në dosjen e Komisionit: shkresë nr. *** prot., datë 7.5.2020, të ISSH-së dhe shkresë nr. *** prot., datë 7.5.2020, të “Raiffeisen Bank”.

³⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.5.2020, të DPPPP-së në dosjen e Komisionit dhe aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁸Shkresë nr. *** prot., datë 7.5.2020, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

³⁹Me maturimin e depozitës është përfutur shuma prej 16.714,59 së bashku me interesat.

<i>Përshkrimi</i>	<i>dhjetor 2005 – 20.6.2014</i>
Pasuritë	3 159 796
Shuma 20.000 euro nga kursimet e pagave si OPGJ	2 671 434
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	488 362
Të ardhurat	6 705 427
Të ardhura nga paga e subjektit	6 022 781
Paga e bashkëshortes	302 646
Kredi tek “Raiffeisen Bank”, 20.12.2006 – 20.12.2009	380 000
Shpenzimet	5 450 350
Shpenzime jetese	1 693 575
Shpenzime udhëtimi	846 332
Paguar këst kredie	518 943
Shpenzime mobilimi	100 000
Përdorur kredi marrë nga “Raiffeisen Bank”	380 000
Paguar ndaj përmbaruesve në BKT në fund të vitit 2013	1 911 500
Mundësia për kursime	-1 904 719

84.1 Kjo analizë është kryer bazuar në metodologjinë kumulative dhe periudha e analizuar është dhjetor 2005 – 20.6.2014, data e emërimit të subjektit në detyrë. Në këtë analizë nuk është përfshirë asnjë nga pasuritë e subjektit të deklaruar si të krijuara me të ardhura nga emigracioni, por janë përfshirë si pasuri:

- shuma 20.000 euro e deklaruar si e krijuar ndër vite deri në datën 20.6.2014 e konvertuar në lekë, duke përdorur kursin mesatar për vitet 2006 – 2014⁴⁰, shumë për të cilat nuk disponohen deklarime të pasurisë së subjektit⁴¹;
- likuiditetet e subjektit dhe të bashkëshortes në banka⁴²;
- depozita e vajzës së subjektit R.R., në “Raiffeisen Bank”, në shumën 1.500 euro⁴³, e cila, sipas deklarimeve të subjektit, por edhe të përshkrimeve të depozitimeve bankare, është derdhur nga gjyshi i vajzës (babai i subjektit);
- gjendja *cash* në shumën 300.000 lekë e deklaruar si kursime nga bashkëshortja e subjektit në DPFD-në e vitit 2014.

Të ardhurat e përfshira në analizë janë: të ardhurat e subjektit si OPGJ; pagat e bashkëshortes nga nëntor 2012⁴⁴; dhe një kredi bankare e marrë në “Raiffeisen Bank”, në vitin 2006.

Shpenzimet ku janë përfshirë shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së dhe përbërjes familjare të subjektit. Konkretisht, nga dhjetori i vitit 2005 vetëm për subjektin, nga data e bashkëjetesës më 4.11.2012 për dy persona, nga lindja e vajzës më 21.2.2013 e në vijim për tre persona.

Janë përfshirë dy pagesa të cilat janë evidentuar gjatë hetimit administrativ në lëvizjet e llogarisë në BKT në datat 6 nëntor dhe 6 dhjetor të vitit 2013, në shumat përkatëse 911.500 lekë dhe 1.000.000 lekë.

⁴⁰Kursi mesatar i përllogaritur për vitet 2006 - 2014 është 1 euro = 135,57 lekë.

⁴¹Sipas ligjit nr. 9049/2003, OPGJ-të nuk parashikohen si subjekte deklaruese.

⁴²Gjendjet e depozitave në datën 31 dhjetor të bashkëshortes pas datës së deklaruar të bashkëjetesës, 4.11.2012.

⁴³Shuma 500 euro është depozituar në datën 31.12.2013 dhe shuma 1.000 euro është depozituar në datën 20.2.2014.

⁴⁴Kohë kur ka filluar bashkëjetesa.

Në analizë janë përfshirë gjithashtu, të gjitha shpenzimet e tjera të kryera gjatë kësaj periudhe.

85. Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të krijuar depozitën prej 20.000 euro në dt. 4.7.2014, e për rrjedhojë dhe shumën e dhënë hua prej 17.000 euro shtetasit B.E. në dt. 15.2.2015. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

86. Në prapësimet e tij, subjekti ka paraqitur një analizë financiare, në të cilën nuk ka përfshirë si shpenzim të tij shumën e paguar në llogarinë e përmbaruesit prej 1.911.400 lekë, në vitin 2013 dhe, si rrjedhim, kjo analizë rezultoi me balancë pozitive. Subjekti pretendon se ka pasur burime të ligjshme për krijimin e shumës 20.000 euro dhe, si rrjedhojë, ka siguruar me të ardhura të ligjshme shumën e dhënë hua shtetasit B.E.

Nëpërmjet kësaj analize, subjekti kërkon sa më poshtë:

- përfshirjen e dhuratës nga gjyshi të mbështet në shumën totale prej 1.500 euro për vitet 2013 dhe 2014;
- mospërfshirjes si shpenzim të shumës 1.911.500 lekë, paguar për përmbaruesin Z.M. në vitin 2013⁴⁵, me pretendimin se shuma 911.500 lekë është dhënë nga babai, i cili ka pasur burime të ligjshme, ndërsa shuma 1.000.000 lekë e ka burimin në kursimet nga emigracioni.

Vlerësimi i Komisionit

87. Në analizë të pretendimeve dhe dokumenteve që subjekti paraqiti, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes:

- Komisioni mori në konsideratë pretendimin se depozitat në llogarinë e vajzave të tij, janë me të ardhura të babait të tij⁴⁶ dhe, për rrjedhojë, shuma 1.500 euro⁴⁷ u përfshi në analizën financiare të rishikuar.
- Transfertat në vitin 2013 në vlerën totale prej 1.911.500 lekësh nuk mund të mos konsiderohen shpenzim sikurse subjekti pretendon, pasi pagesat janë kryer nga subjekti, por në analizën financiare përfundimtare, u përfshi si e ardhur e ligjshme shuma 911.500 lekë dhënë nga babai i subjektit, sikurse subjekti pretendoi. Kjo për faktin se, subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë më parë burimin e krijimit të të ardhurave për transfertat bankare objekt verifikimi (të cilat u evidentuan nga Komisioni) dhe, për rrjedhojë, u çmua të merret në konsideratë deklarimi i tij gjatë procesit se kjo shume është me burim të ardhura të babait të tij, të cilat bazuar në dokumentat që subjekti ka paraqitur bashkëlidhur parashtrimeve, kanë qenë të mjaftueshme për dhënien e shumës 911.500 lekë.
- Subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave nga emigracioni dhe për rrjedhojë, shuma 1.000.000 lekë nuk mund të konsiderohet si e ardhur me burime të ligjshme. Për më tepër, nuk është bindës fakti që kjo shumë është ruajtur *cash* nga viti 2005 për t'u përdorur në fund të vitit 2013.
- Nga analiza e rishikuar, rezultati financiar, për periudhën dhjetor 2005 – 20.6.2014, ka ndryshuar nga -1.904.719 lekë, në -785.830 lekë, pra, përsëri subjekti është nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të krijuar kursimin në shumën 20.000 euro.

⁴⁵Trajtuar në paragrafin 99 të vendimit.

⁴⁶Trajtuar në paragrafin 40 të këtij vendimi.

⁴⁷Kjo shumë është depozituar nga babai i subjektit në llogarinë e mbështetës së tij (vajzës së subjektit), e përbërë nga: vlera 500 euro në dhjetor të vitit 2013 dhe vlera 1.000 euro në shkurt të vitit 2014.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur/N.F.R.

88. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Llogari bankare në emër të N.R., në ‘Raiffeisen Bank’ (depozitë). Shumë e përfituar nga puna si notere, pranë Drejtorisë Rajonale Shëndetit Berat, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Vlera: 920.682.31 (nëntëqind e njëzet mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy e tridhjetë e një). Pjesa takuese: 100%”.

Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këtë llogari bankare, rezultoi se:

88.1 Nga lëvizjet e llogarisë në “Raiffeisen Bank”⁴⁸, është evidentuar se në datën 24.12.2015 bashkëshortja e subjektit ka depozituar *cash* shumën 350.000 lekë. Në datën e depozitimit është çelur një depozitë me afat 1-vjeçar në këtë shumë, me maturim në datën 22.12.2016.

88.2. Për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortes së tij, për krijimin e kësaj depozite, është kryer analiza financiare për periudhën nga 30.7.2015⁴⁹ deri në ditën e depozitimit të shumës 350.000 lekë në datën 24.12.2015. Nga kjo analizë ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi të krijojnë shumën 350.000 lekë, megjithëse ka rezultuar një balancë negative në vlerë të pakonsiderueshme prej 21.449 lekësh.

Përshkrimi	30.7.2015 – 24.12.2015
Pasuritë	397 876
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	397 876
Gjendja e likuiditeteve në bankë	2 827 550
Të ardhurat	1 037 288
Të ardhura nga paga e subjektit	422 235
Fitimi nga noteria bashkëshortja	612 802
Të ardhura nga interesa bankare	2 251
Shpenzimet	660 862
Shpenzime jetese	358 219
Shpenzime udhëtimi	256 103
Shpenzime transporti	38 540
Shpenzime për kopshtin e fëmijëve	8 000
Mundësia për kursime	-21 449

89. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Llogari bankare në emër të N.R., në ‘Raiffeisen Bank’ në euro, e cila përdoret në funksion të punës së saj si notere, për të transferua detyrimeve noteriale, si dhe ngrirja për shitblerje të pasurisë të paluajtshme. Vlera: 0 (zero) lekë”.

Me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2020, “Raiffeisen Bank” konfirmon llogarinë në euro me nr. ***, të personit fizik “N.F.R.” dhe gjendjen e kësaj llogarie në vlerën 0 (zero) lekë. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin bankar.

90. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Llogari bankare në emër të N.R., në ‘Raiffeisen Bank’ në lekë, e cila përdoret në funksion të punës së saj si notere, për të transferua detyrimeve noteriale si dhe ngrirja për shitblerje të pasurisë të paluajtshme. Vlera: 124.917 (një qind e njëzete e katër mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë”.

⁴⁸Shkresë nr. *** prot., datën 7.5.2020, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹Në datën 30.7.2015 subjekti ka blerë një automjet, për të cilin është bërë analizë financiare më vete. Kështu, analiza për krijimin e gjendjes *cash* fillon në datën 30.7.2015, për të nxjerrë efektin financiar vetëm për depozitën prej 350.000 lekësh dhe për të shmangur mbivendosjen e rezultatit negativ të periudhës së mëparshme.

Me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2020, “Raiffeisen Bank” konfirmon llogarinë në lekë me nr. ***, të Personit Fizik “N.F.R.” dhe gjendjen e kësaj llogarie në vlerën 124.917 lekë. Përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me dokumentacionin bankar.

91. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Llogari bankare në emër të N.R., në ‘Raiffeisen Bank’ në lekë, e cila përdoret në funksion të zyrës noteriale për të bërë pagesat e tatimeve-taksave dhe detyrimeve të tjera të zyrës. Vlera: 4.222,92 (katër mijë dyqind e njëzetë e dy prejse nëntëdhjetë e dy)*”.

Me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2020, “Raiffeisen Bank” konfirmon llogarinë në lekë me nr. ***, të personit fizik “N.F.R.” dhe gjendjen e kësaj llogarie në vlerën 124.917 lekë. Përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me dokumentacionin bankar.

92. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Llogari bankare në emër të N.R., në NBG në euro, e cila përdoret në funksion të punës së saj si notere, për transferta detyrimeve noteriale, si dhe ngrirja për shitblerje të pasurive të paluajtshme. Nuk është deklaruar vlerë*”.

Me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2021, ABI Bank (ish-NBG) konfirmon llogarinë në euro me nr. *** të Personit Fizik “N.F.R.” dhe gjendjen e kësaj llogarie në vlerën 0 (zero) lekë. Përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me dokumentacionin bankar.

93. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Llogari bankare në emër të N.R., në NBG në euro, e cila përdoret në funksion të punës së saj si notere, për transferta detyrimeve noteriale, si dhe ngrirja për shitblerje të pasurive të paluajtshme. Nuk deklaruar vlerë*”.

Nga verifikimi i informacionit të përcjellë nga ABI Bank ka rezultuar se bashkëshortja ka vetëm një llogari në euro, e cila përdoret për transferta të detyrimeve noteriale, si dhe ngrirjen për shitblerje të pasurive të paluajtshme dhe jo dy, sikurse ka deklaruar subjekti (përshkruar në pikat 92 dhe 93 të këtij vendimi)

94. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Llogari bankare në emër të N.R., në NBG në lekë, e cila përdoret në funksion të punës së saj si notere detyrimet noteriale që kanë klientët e bankës ndaj noterës për kontrata noteriale. Nuk ka deklaruar vlerë*”.

Nga verifikimi i informacionit të përcjellë nga ABI Bank, përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me dokumentacionin bankar. Veç kësaj, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2021, ABI Bank (ish-NBG) konfirmon se bashkëshortja e subjektit ka dy llogari në lekë, të cilat përdoren për transferta të detyrimeve noteriale, si dhe ngrirjen për shitblerje të pasurive të paluajtshme, dhe jo një, sikurse ka deklaruar subjekti, përshkruar në paragrafin 94⁵⁰.

95. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Llogari bankare në emër të N.R., në ‘Fibank’ në funksion të punës si notere për transferta detyrimeve noteriale, si dhe ngrirja për shitblerje të pasurive të paluajtshme. Nuk ka deklaruar vlerë*”.

Me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2020, “Fibank” konfirmon llogari tjetërsimi në lekë me nr. ***, të personit fizik “N.F.R.”, me gjendje 0 (zero) lekë. Përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit, me dokumentacionin bankar.

⁵⁰ Gjithashtu, bashkëshortja e subjektit N.R. ka edhe një llogari të personit fizik në lekë në këtë bankë (pra tek ABI Bank), e cila nuk është deklaruar nga subjekti që e përdor për kryerjen e pagesave të ushtrimit të aktivitetit si person fizik. Kjo llogari është çelur në mars të vitit 2016 dhe gjendja e saj në fund të këtij viti dhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* është 0 (zero) lekë.

KONSTATIME TË TJERA

96. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile dhe adresë banimi, *bulevardi "R.", Berat*. Në deklaratat periodike vjetore subjekti ka deklaruar si adresë banimi: *lagjja "****", bulevardi 'R.', Berat*, adresa të një banese në pronësi të prindërve të tij. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti nuk ka specifikuar ndonjë adresë të ndryshme nga ato të deklaruara ndër vite dhe në deklaratën *Vetting*, por ka sqaruar se⁵¹ ka qëndruar në shtëpinë prindërve të tij, ndërsa *ata kanë marrë edhe një apartament në të njëjtin kat për mirëmbajtje*.

96.1. Për shkak të këtyre deklarimeve të paqarta iu kërkua subjektit të paraqesë dokumentet e pronësisë si dhe mënyrën e përfitimit të banesës nga prindërit e tij. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk ka dhënë shpjegime, por ka bashkëngjitur dy aktet shkresore të poshtëshënuara:

- kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme, datë 4.10.1993, me shitës Ndërmarrja Komunale Banesave Berat dhe blerës T. dhe M.R. për apartamentin në pallatin nr. ***, i ndodhur në lagjen "****", Berat;

- kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 12.4.1999, me anë të së cilës T.R. dhe M.R. (prindërit e subjektit) kanë blerë prej shtetasës L.P. apartamentin në lagjen "****", në pallatin nr. ***, kundrejt shumës 1.900.000 lekë.

96.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e ASHK-së Berat kanë rezultuar të dhëna për dy pasuri të regjistruara në emër të T. Z. R. dhe M.I.R., përkatësisht pasuria *** dhe ***, të cilat ndodhen në të njëjtën adresë, në të njëjtin pallat e kat dhe i përkasin dy kontratave të sipërpërmendura. Për të dyja këto pasuri janë lidhur kontratat përkatëse⁵² me UKT-në dhe FSHU-në.

96.3 Për shkak se në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk ka dhënë sqarime në lidhje me pyetjen: *"Shpjegoni se çfarë keni parasysh me deklarinimin që prindërit tuaj kanë marrë dhe një apartament në të njëjtin kat për mirëmbajtje"*, gjatë procesit iu drejtua sërish e njëjta pyetje, dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 3 deklaroi se: *"Ju sqaroj se prindërit e mi e përdorin apartamentin që ndodhet në të njëjtin kat me apartamentet në të cilin ne jetojnë në lagjen "****" në Berat, apartament të cilin e kanë në përdorim (ruajtje) dhe përdoret më së shumti gjatë fundjavave kur në Berat vjen dhe vëllai im G.R. dhe familja e tij bashkëshortja dhe tre djemtë e tij (i cili banon edhe në Tiranë). Bashkëlidhur po ju vë në dispozicion edhe kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme së pasurisë së P.Z."*

Sipas kësaj karte të lëshuar në datën 19.10.2021, nga ZVRPP-ja Berat, vërtetohet se apartamenti me sip. 53 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë lagjja "****", p. ***, sh. ***, ap. ***, figuron në pronësi të H.Y.Z. dhe P.B.Z., i regjistruar në datën 21.11.2000, me shënimin *kontratë shitjeje E.K.B.* Ky apartament duket që është në të njëjtin kat me dy apartamentet e prindërve të subjektit.

96.4. Nga sa më sipër u vërtetua se: (i) prindërit e subjektit kanë në pronësi të tyre dy apartamente, në njërin prej të cilëve banon subjekti dhe që ndodhen në të njëjtën adresë të deklaruar nga subjekti; (ii) këto dy pasuri janë fituar nga prindërit e subjektit në mënyrë të ligjshme njëra me privatizim nga Ndërmarrja Komunale e Banesave Berat në vitin 1993 dhe tjetra është blerë nga individ në vitin 1999; (iii) të dyja pasuritë janë blerë kur subjekti ka qenë përkatësisht 14 vjeç dhe 20 vjeç. Në këto rrethana, nuk u vërtetua asnjë lidhje dhe/ose kontribut i subjektit në krijimin e këtyre pasurive dhe, për rrjedhojë, Komisioni çmoi si të panevojshme kryerjen e hetimeve të mëtejshme në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për

⁵¹Shihni përgjigjet e pyetjeve 1 dhe 14 të këtij pyetësori.

⁵²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2021, UK-të Berat, Kuçovë, librezë uji në emër të shtetasit T.R. (babai i subjektit) me nr. kontrate *** dhe librezë energjie elektrike në emër të T.R. me nr. kontrate ***. Paraqitur nga subjekti në dosjen e Komisionit.

krijimin e dy pasurive të prindërve të subjektit, njëra prej të cilave është në përdorim të subjektit.

96.5. Pavarësisht se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si adresë të Gjendjes Civile dhe adresë banimi *Bulevardi "R." Berat*, nuk e ka deklaruar pasurinë apartament në përdorim, në përputhje me shtojcën nr. 2 dhe pikën 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 sipas të cilave "*pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit*". Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti i është kërkuar të japë sqarime mbi këtë konstatim.

96.6. Komisioni e vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit se në kushtet kur burimi i krijimit të kësaj pasurie është i ligjshëm dhe ai e ka deklaruar si adresë banimi këtë apartament në të gjitha deklaratat e pasurisë, vërtetohet tej çdo dyshimi se ai nuk ka pasur asnjë qëllim për mosdeklarimin e kësaj pasurie dhe, në këto kushte, kjo pasaktësi nuk mund të shërbejë për marrjen e ndonjë mase disiplinore sipas edhe praktikës tashmë të konsoliduar të Komisionit dhe të Kolegjit. Në përfundim, mosdeklarimi i përdorimit të kësaj banese vlerësohet nga Komisioni i paqëllimshëm, për sa kohë në të gjitha DPV-të është deklaruar adresa e kësaj banese.

97. Në DPDFD-në, plotësuar në korrik të vitit 2014, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar 3.000.000 lekë kursime *cash* me burim nga kursimet e pagës si shefe personeli pranë DSHP-së Berat, si dhe specialiste të ZVRPP-ja Berat. I pyetur pranë ILDKPKI-së mbi burimin e kësaj shume, në procesverbalin e datës 27.1.2016 subjekti ka sqaruar se deklarimi i bashkëshortes është bërë gabim pasi gjendja *cash* e akumuluar ka qenë 300.000 lekë dhe jo 3.000.000 lekë, të përfituara nga puna e saj. I pyetur nëse bashkëshortja vazhdon ta disponojë këtë shumë apo është shpenzuar⁵³ subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si në ILDKPKI, pa iu përgjigjur pyetjes të Komisionit, duke theksuar se shuma është deklaruar me lekë të vjetra për shkak të një gabimi njerëzor.

97.1. Sa i takon shumës së deklaruar, duket se shpjegimi i subjektit qëndron pasi paga e bashkëshortes në institucionet dhe periudhën e deklaruar nga subjekti kanë qenë 302.646 lekë, shumë e cila logjikisht justifikon një kursim *cash* të shumës 300.000 lekë.

97.2. Sa i takon faktit nëse shuma 300.000 lekë, është shpenzuar apo është mbartur në vitet e ardhshme, Komisioni është mbështetur në verifikimin e DPV-ve nga viti 2014 deri në vitin 2016, ku subjekti nuk ka deklaruar as shtesa as pakësime të gjendjes *cash*. Ndersa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar gjendje *cash* vetëm likuiditetin 1.500.000 lekë me burim të ardhura nga emigracioni dhe shitjen e pasurisë në Gj. Tiranë. Për këtë arsye është vlerësuar që shuma 300.000 lekë, e deklaruar si gjendje *cash* nga bashkëshortja në DPDFD për 2014, është shpenzuar deri në fund të këtij viti.

98. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezultoi se subjekti ka udhëtuar jashtë shtetit me automjetet me targa: ****; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ****; ****; ****; ****. I pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar në lidhje me pronësinë dhe qëllimet e udhëtimit me këto mjete. Pasi u verifikuan deklaratimet e subjektit dhe të dhënat në sistemin AMF, u kërkuar informacione nëse subjekti është gjendur në situatë të konfliktit të interesit me pronarët e deklaruar nga subjekti apo pronarët/përdoruesit e mjeteve sipas sistemit AMF. Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Fier ku subjekti ka ushtruar detyrën, nuk konfirmuan kallëzime/procedime penale të hetuara nga

⁵³Shihni pyetësorin nr. 4, të administruar në dosjen e Komisionit.

subjekti për këta shtetas. Po kështu, SPAK-u nuk ka konfirmuar procedime penale të regjistruara në emër të shtetasve sa më sipër⁵⁴.

99. Nga lëvizjet në llogarinë e subjektit në BKT rezultoi se: (i) në datën 6.11.2013, subjekti ka depozituar *cash* shumën 911.500 lekë, e cila në të njëjtën datë është transferuar te shtetasi Z.M.⁵⁵; (ii) në datën 4.12.2013, subjekti ka depozituar *cash* shumën 1.000.000 lekë, e cila në datën 6.12.2013, është transferuar te shtetasi Z.M. (M.) me përshkrimin “të ardhura nga kursime”. Në lidhje me këto dy depozitime u kryen verifikimet si vijojnë:

99.1 Iu kërkua subjektit që të deklarojë të ardhurat që kanë shërbyer si burim krijimi për të dyja depozitimet *cash*, identiteti i plotë i shtetasit Z.M./M., marrëdhënia me të si dhe arsyeja e transfertave. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, deklaroi se si burim për depozitim e shumave kanë shërbyer të ardhurat nga paga si OPGj nga viti 2005 deri në momentin që janë bërë transfertat, si dhe ndihma nga prindërit e tij, pa përcaktuar sa ka qenë kontributi i tyre dhe pa paraqitur ndonjë dokument që vërteton të ardhura të tyre. Për sa i përket arsyes së transfertave subjekti ka deklaruar se: “... *shumat me vlerën prej 911.500 lekësh dhe shuma në vlerën prej 1.000.000 lekësh janë shuma, të cilat janë të transferuara në llogari të shtetasit Z.M. (i cili ka qenë përmbarues) dhe këto shuma kanë shërbyer për pagimin e detyrimeve të mia kundrejt aksioneres tjetër të shoqërisë që doja të krijoja, shuma të cilat ajo i pretendonte karshi meje*”. Subjekti nuk paraqiti dokumente në mbështetje të pretendimeve të tij, si dhe nuk paraqiti identitetin e plotë të shtetasit Z.M.

99.2 Nga verifikimi i regjistrimit *online* i përmbaruesve gjyqësorë privatë⁵⁶ shtetasi Z.M. figuron përmbarues gjyqësor me nr. certifikate ***, me datë fillimi të veprimtarisë 20.6.2012, në Tiranë, me NIPT ***. Ndërsa, në sistemin *online* të QKB-së rezulton subjekti Z.M., person fizik, me NIPT ***, i regjistruar në datën 6.1.2014, me fushë veprimtarie “Përmbarues privat”, me status “çregjistruar” në datën 11.12.2020.

99.3 Në lidhje me shumat e derdhura *cash* në BKT, në total prej 1.911.500 lekësh, ato janë përfshirë si shpenzim i subjektit në analizën financiare të kryer në përfundim të hetimit administrativ për periudhën nëntor 2005 deri në 2013 si në tabelën më poshtë, sipas të cilës, duket se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtyre dy shumave.

<i>Përshkrimi</i>	<i>dhjetor 2005 – dhjetor 2013</i>
Pasuritë	13 956
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	13 956
Të ardhurat	6 061 777
Të ardhura nga paga e subjektit	5 520 205
Paga e bashkëshortes	161 572
Kredi nga “Raiffeisen Bank”	380 000
Shpenzimet	5 002 465
Shpenzime jetese	1 363 578
Shpenzime udhëtimi	728 444
Paguar këste kredie te “Raiffeisen Bank”	518 943
Shpenzime mobilimi	100 000

⁵⁴Shihni shkresat: nr. *** prot., datë 8.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresë nr. *** prot., datë 16.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresë nr. *** prot., datë 11.11.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

⁵⁵Në lëvizjet e llogarisë figuron një herë si Z.M. dhe një herë si Z.M. Nga verifikimi në Gjendjen Civile rezulton një shtetas me gjeneralitete Z.M., i cili figuron përmbarues në listën e përmbaruesve.

⁵⁶Shihni: <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Regjistri-i-P%C3%ABrmbauesve-Gjyq%C3%ABsor%C3%AB-Privat%C3%AB-i-p%C3%ABrdit%C3%ABsuar-17.02.2021.pdf>.

Përdorur kredia e marrë nga "Raiffeisen Bank"	380 000
Paguar ndaj përmbaruesve në BKT	1 911 500
Mundësia për kursime (kumulative)	1 045 356

99.4. Pavarësisht se kjo analizë ka rezultuar me balancë pozitive, subjekti në parashtrime ka pretenduar që shuma e transfertave në vitin 2013 në vlerën totale prej 1.911.500 lekësh nuk duhet të konsiderohet si shpenzim i tij. Sa i takon këtij pretendimi, Komisioni çmoi të justifikojë me të ardhura të ligjshme dhe ta heqë nga shpenzimet e subjektit vetëm depozitën në shumën 911.500 lekë dhënë nga babai i subjektit (trajtuar hollesisht në paragrafët 86 dhe 87 të këtij vendimi). Për rrjedhojë analiza financiare ndryshoi nga +1.045.356 lekë në +1.956.856 lekë, duke mos afektuar kështu ndonjë konkluzion të Komisionit për mundësinë financiare të subjektit në kryerjen e këtyre shpenzimeve.

Analizë financiare

100. Për të verifikuar justifikimin e pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting*, të krijuara para fillimit të detyrës dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, sikurse është shtjelluar më hollësisht më sipër në këtë vendim, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor është kryer analiza financiare e subjektit bazuar në vlerën e pasurive, të ardhurat dhe shpenzimet. Në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se: (i) sa i takon periudhës para fillimit të detyrës, duket se subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit në O., Vlorë, në shumën 4.822.354 lekë/34.800 euro; (ii) sa i takon periudhës nga emërimi në detyrë datë 20.6.2014, deri më 31.12.2016, pamundësia totale e subjektit (shuma e viteve me balancë negative) është në vlerën 5.649.849 lekë, siç pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese.

Përshkrimi	20.6.2014	2015	2016
Pasuritë	4 104 636	1 285 898	537 780
Autoveturë tip "Volkswagen", viti 2011, me targa AA 838 KC		700 000	
Dhënë hua te B.E.		2 382 380	
Depozituar shuma 20.000 euro	2 802 800		
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>1 301 836</i>	<i>-1 796 482</i>	<i>537 780</i>
Gjendja e likuiditeteve (bankë dhe <i>cash</i>)	4 592 998	2 796 517	3 334 296
Të ardhurat	3 441 035	2 486 340	2 254 904
Të ardhura nga paga e subjektit	403 083	1 013 364	1 043 207
Paga e bashkëshortes	240 935		
Fitimi nga noteria bashkëshortja	-5 783	1 470 725	1 211 697
Të ardhura nga interesa bankare		2 251	
Kursimi prej 20.000 euro nga paga si OPGJ	2 802 800		
Shpenzimet	4 752 707	1 433 983	1 287 666
Shpenzime jetese	211 536	859 725	940 368
Shpenzime udhëtimi	184 191	350 083	285 518
Shpenzime transporti	54 180	105 985	43 780
Shpenzime hipoteke		110 190	
Shpenzime për kopshtin e fëmijëve		8 000	18 000
Sistemim veprimi për burimin e paligjshëm për gjendjen <i>cash</i> 1.500.000 lekë	1 500 000		

Sistemim veprimi për burimin e paligjshëm për gjendjen <i>cash</i> 20.000 euro	2 802 800		
Mundësia për kursime	-5 416 308	-233 540	429 458

101. Në parashtrimet e veta, subjekti ka ngritur pretendime në lidhje me analizën financiare për të dyja periudhat, të cilat janë trajtuar hollësisht në këtë vendim. Sa i takon periudhës së rivlerësimit 20.06.2014 - 31.12.2016, shuma e viteve me balanca negative ndryshon nga vlera 5.649.849 lekë dërguar me rezultatet e hetimit, në vlerën 5.560.824 lekë, për shkak të njohjes si e ardhur e ligjshme e shumave të depozituara në llogaritë e vajzave të subjektit nga babai i tij⁵⁷.

Vlen të theksohet se në parashtrimet e veta, subjekti pretendon që të përfshihen në analizën financiare të gjitha kursimet e prindërve të tij, për periudhën 1994 deri në fillimin e detyrës me datë 20.6.2014, të vlerësuara prej tij në shumën 4.696.862 lekë. Subjekti ka paraqitur një analizë financiare të prindërve për periudhën 1994 – 20.6.2014, sipas së cilës ata kanë pasur mundësi për kursime në këtë vlerë. Pasi u shqyrtua nga Komisioni, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, u vlerësua që kjo analizë nuk mund të merret e mirëqenë, pasi është bazuar vetëm në të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës së prindërve, paraqitur nga subjekti vetëm pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ dhe nuk ka të dhëna në lidhje me pasuri të çdo lloji apo shpenzime të tjera të tyre dhe për rrjedhojë, ajo është një analizë indikative. Për këtë arsye, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni rrëzoi pretendimin e subjektit që kursimi i pretenduar me vlerë prej 4.696.862 lekësh i prindërve, të përfshihet si e ardhur e ligjshme në analizën e tij financiare. Per te arritur në këtë përfundim, Komisioni iu referua edhe fakteve se: (i) subjekti, me përjashtim të DPV-së për vitin 2016, ku si burim për krijimin e llogarive bankare të vajzave ka deklaruar të ardhura nga prindërit, në asnjë prej DPV-ve nuk ka deklaruar dhurime/ndihmë financiare nga prindërit si burime të krijimit të pasurive të tij, të cilat i ka pretenduar vetëm gjatë hetimit administrativ; (ii) në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar për herë të parë si një nga burimet e krijimit të pasurisë në O. edhe ndihmë financiare nga prindërit, ndërkohë që në DPV për vitin 2014 ka deklaruar si burim vetëm të ardhura nga emigracioni, të ardhura të cilat nuk arriti t'i vërtetonte.

Megjithatë, edhe në rast se Komisioni, në një qasje garantiste ndaj subjektit do të konsideronte dy elementë dhe pikërisht përfshirjen në analizën e vitit 2014 të pjesës takuese të shumës 20.000 euro të krijuar me burime të ligjshme⁵⁸, si dhe likuiditetin *cash* prej 1.500.000 lekësh, do ta konsideronte me të ardhura të ligjshme, balanca negative për periudhën e rivlerësimit do të ishte në shumën 2.175.219 lekë, shumë që do të përbënte shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

Metodologjia e përdorur gjatë analizës financiare

102. Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

102.1 Të ardhurat

Subjekti është analizuar për periudhën e rivlerësimit që përfshin periudhën 20.6.2014 deri 31.12.2016 sipas përbërjes së tij familjare dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare janë konsideruar të ardhurat e dokumentuara të:

⁵⁷ Trajtuar hollësisht në paragrafët 37 - 40 të vendimit.

⁵⁸Diferenca e vlerës 20.000 euro me pamundësinë e subjektit për periudhën dhjetor 2005 – 20.6.2014 prej 785.830 lekësh, e barabartë me vlerën 1.885.604 lekë, të konsiderohet e ardhur e ligjshme.

- pagave të tij e tij nga data e emërimit në detyrë deri në fund të periudhës së rivlerësimit⁵⁹;
- të ardhura nga paga e bashkëshortes së subjektit, nga fillimi i bashkëjetesës në nëntor 2012 deri në fund të periudhës së rivlerësimit⁶⁰;
- fitimi *neto* i bashkëshortes nga aktiviteti i saj si notere në Berat⁶¹;
- të ardhura nga interesa bankare sipas informacionit të përcjellë nga “Raiffeisen Bank”⁶².

102.2 Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë konsideruar sipas standardit të ILDKPKI-së për vitet kur subjekti ka qenë në detyrë dhe në varësi të përbërjes së tij familjare: nga fillimi i detyrës deri më 9.3.2015 janë përfshirë shpenzime jetese për 3 persona, subjekti, bashkëshortja dhe vajza e tyre; nga lindja e fëmijës së dytë, për 4 persona.
- Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe në sqarimet e dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Shpenzimet e transportit nga vendi i punës në banesë dhe anasjelltas janë konsideruar sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin standard dhe në pyetësorin nr. 2 dhe janë përlllogaritur në këtë mënyrë.
 - Për periudhën 20.6.2014 – 4.8.2014, subjekti ka udhëtuar nga Berati në Vlorë dhe anasjelltas, me mjete të transportit publik. Çmimi i biletës Berat-Vlorë-Berat është konsideruar në vlerën 500 lekë dhe 1 muaj është konsideruar me 22 ditë pune.
 - Për periudhën 4.8.2014 deri korrik 2015 subjekti ka deklaruar se ka udhëtuar nga Berati në Fier me dy kolegë të tij D. B. dhe R. C. me automjetin e njërit prej tyre dhe se shpenzimet janë ndarë në 3. Shpenzimet e transportit janë përlllogaritur si 1/3 e karburantit të shpenzuar⁶³ duke konsideruar distancën Berat-Fier-Berat.
 - Për periudhën korrik 2015 deri 31.12.2016, subjekti ka deklaruar se ka udhëtuar me mjetin e tij me targa *** ose me mjetin e kolegut A. L. dhe se shpenzimet janë ndarë midis tyre. Shpenzimet e transportit janë përlllogaritur si 1/2 e karburantit të shpenzuar duke konsideruar distancën Berat-Fier-Berat.
- Është përfshirë çdo shpenzim i evidentuar gjatë hetimit administrativ nga dokumente të administruara në dosjet e Komisionit dhe ILDKPKI-së.

102.3 Pasuritë

- Është përfshirë shuma 20.000 euro, e cila është krijuar nga subjekti gjatë viteve para detyrës si prokuror dhe depozituar në bankë në datën 4.7.2014.
- Blerja e automjetit tip “Volkswagen” në korrik të vitit 2015.
- Shuma 1.500.000 lekë, e krijuar para detyrës dhe e mbartur si gjendje *cash* deri në deklaratën *Vetting*.
- Gjendjet e likuiditeteve nëpër banka të subjektit, bashkëshortes dhe fëmijëve të tij⁶⁴ në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash*, sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.

⁵⁹Vërtetimet: nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën e punësimit si prokuror nga 4.8.2014 deri 30.11.2014; nr. *** prot., datë 24.1.2017 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën e punësimit si prokuror nga 1.1.2015 deri 31.12.2016.

⁶⁰Vërtetimet: nr. *** prot., datë 21.10.2016 nga Drejtoria Shëndetësore Berat; nr. *** prot., datë 7.5.2020, nga ISSH-ja për periudhën e punësimit nga viti 2010 deri shkurt 2013; nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga ZVRPP-ja Berat për periudhën e punësimit 10.3.2014 deri 2.12.2014.

⁶¹Shkresa nr. *** prot., datë 10.8.2017, nga DRT-ja Berat, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶²Shkresa nr. *** prot., datë 7.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶³Distanca x 7 litra/100 km x çmimi mesatar i karburantit për atë vit.

⁶⁴Shkresat: nr. *** prot., datë 7.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”; nr. *** prot., datë 12.5.2020, nga BKT-ja; nr. *** prot., datë 11.8.2020, nga “Credins Bank”; nr. *** prot., datë 11.5.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”; nr. *** prot., datë 30.4.2020, nga “ABI Bank”.

Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.

Shuma e pasurive dhe likuiditeteve përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti, nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë

103. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmoi se subjekti ka kryer deklarime të pasakta, kontradiktore e të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, si dhe nuk justifikoi pasuritë dhe shpenzimet me të ardhura të ligjshme, të cilat përbejnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas parashikimit të nenit 63/1 të ligjit nr. 84/2016.

Rivlerësimi i figurës

104. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 20.12.2021 të KDZH-së, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Erind T. Reovica.

105. Gjatë hetimit administrativ, institucionet ligjzbatuese kanë vënë në dispozicion të Komisionit informacione konfidenciale për kontakte të papërshtatshme të subjektit me disa persona të përfshirë në veprimtari kriminale. Pasi Komisioni verifikoi këto informacione, me qëllim vërtetimin e tyre, ndërmori veprimet hetimore si vijojnë:

- U pyet subjekti për relatat me shtetasit për të cilët kishte të dhëna konfidenciale dhe në përgjigjet e dërguara me *e-mail* të datës 14.12.2021, deklaroi se disa prej tyre i njeh si emra për shkak se kanë qenë nga Berati, por mohoi të ketë pasur marrëdhënie të çdo lloji me ta, apo të ketë trajtuar çështje penale në ngarkim të tyre.

- Me kërkesë të Komisionit, SPAK-u informoi se për disa prej shtetasve për të cilët kishte të dhëna konfidenciale, rezultoi të ketë procedime penale për vepra që përfshihen në veprimtari të krimit të organizuar⁶⁵.

- U verifikuan të dhënat në sistemin *TIMS* dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë udhëtuar me asnjë prej këtyre shtetasve.

- Duke qenë se ka pasur të dhëna që për subjektin e rivlerësimit është shpërndarë një informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë për Krimet e Rënda në vitin 2009, nga Komisioni u kërkua informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe SPAK. Prokuroria e Përgjithshme bëri me dije se informacioni i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda⁶⁶. Ndërkohë, SPAK-u informoi se nuk rezultoi që në emër të shtetasit Erind T. Reovica të jetë regjistruar ndonjë procedim penal⁶⁷.

106. Nga Komisioni i është bërë kërkesë DSIK-së për përditësimin e informacionit për subjektin e rivlerësimit dhe nëse kishte vend, të bëhej rishikimi i raportit. Me shkresën nr. *** prot., datë 13.1.2022, DSIK-ja ka vënë në dispozicion raportin e dytë të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 13.1.2022, të KDZH-së, sipas të cilit është ndryshuar konstatimi fillestar nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për ushtrimin e detyrës. Në këtë raport evidentohet se: *“Gjatë periudhës në të cilën z. Reovica ushtronte detyrën si prokuror jemi informuar mbi të dhënat me kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”*.

⁶⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.12.2021.

⁶⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.1.2022.

⁶⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.1.2021.

107. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime dhe dokumente në lidhje me konstatimet e DSIK-së. Në prapësimet e tij, subjekti ka kundërshtuar përfundimin në të cilin ka arritur Grupi i Punës, duke e konsideruar atë jologjik dhe të pabazuar. Ndër të tjera, subjekti, ashtu sikurse dhe gjatë procesit, ka parashtruar se me kërkesë të Komisionit ka dhënë sqarime për të gjithë shtetasit për të cilët është pyetur, disa prej të cilëve i njuh por me asnjë prej tyre nuk ka lidhje shoqërore/miqësore dhe se asnjë prej tyre nuk ka qenë palë në procedime penale të ndjekura prej tij në detyrën e prokurorit, fakt të cilin nuk e ka vërtetuar me ndonjë dokument shkresor. Gjithashtu ka theksuar se sipas të dhënave në sistemin *TIMS*, nuk rezulton që të ketë udhëtuar me shtetasit që referojnë informacionet konfidenciale, fakt që tregon se nuk ka pasur lidhje shoqërore apo miqësore me këta shtetas.

108. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, pavarësisht se për një pjesë të personave për të cilët kishte informacione konfidenciale janë evidentuar procedime penale për vepra të përfshirjes në krimin e organizuar, kontakti i subjektit me këta persona mbetet në nivel dyshimesh dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin që subjekti ka kontakte të papërshtatshme në kuptim të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, fakt që do të cenonte figurën e tij sipas parashikimit të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës. Po kështu, nuk u evidentuan të dhëna për përfshirje të subjektit në veprimtari korruptive.

109. Në këto rrethana, bazuar në të dhënat që disponon Komisioni nuk mund të vlerësojë se subjekti është i papërshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, referuar kriterit të vlerësimit të kontrollit të figurës.

Vlerësimi profesional

110. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Erind Reovica, bazuar në: (i) raportin nr. *** prot., datë 10.12.2021, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 22.12.2021; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Informacion i marrë nga raporti i KLP-së

111. Raporti për analizimin e aftësive profesionale, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është bazuar në: formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, nga analiza e të cilave nuk janë evidentuar problematika.

112. Në rubrikën të dhëna nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore u konstatua se ndaj subjektit Erind Reovica nuk ka pasur masa disiplinore, nuk ka pasur ndaj tij materiale hetimore të regjistruara, procedime penale të pushuara apo pezulluara. Ndërkohë, rezulton se ka pasur 1 ankesë për periudhën 2006 – 2020, ku evidentohet se shtetasi T.K. ka bërë kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier ndaj dy shtetasve me objekt falsifikimin e dokumenteve. Procedimi penal në fjalë iu ngarkua prokurorit Erind Reovica. Ankuesi pretendon se prej momentit të regjistrimit nuk kishte marrë asnjë informacion mbi hetimet dhe duke qenë se kishte kaluar një kohë përtej çdo afati ligjor, nga ana e prokurorit zvarritet qëllimisht hetimi për të favorizuar të dyshuarit. Ankesa në fjalë është marrë në shqyrtim nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet shkresës nr.*** prot., datë 17.8.2018, ka bërë me dije se rastin ia kishte dërguar për vlerësim dhe zgjidhje ligjore Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit i është kërkuar të japë sqarime e të paraqesë dokumente shkresore se çfarë është vendosur në lidhje me këtë ankesë, si dhe në lidhje me pretendimet e shtetasit T.K. Në parashtrimet e veta, subjekti ka deklaruar në mënyrë koncize se: *“Në lidhje me këtë ankesë ju informoj se ankuesi (kallëzuesi) është pritur disa herë nga oficeri i policisë gjyqësore A.L. dhe i është dhënë informacioni i duhur në lidhje me këtë procedim dhe janë dhënë sqarimet e duhura në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore të kryera nga ana jonë. Janë kryer një sërë veprimesh hetimore në lidhje me pretendimet e ngritura nga ana e kallëzuesit gjatë intervistimit me oficerin e policisë gjyqësore”*. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti deklaroi se ka bashkëngjitur deklaratën e oficerit të policisë gjyqësore, por nuk rezultoi ta ketë paraqitur këtë deklaratë. Siç vërehet, subjekti nuk ka dhënë deklaratime dhe as dokumente shkresore për të vërtetuar se çfarë është vendosur në lidhje me ankesën e shtetasit T.K., si dhe në lidhje me pretendimet e tij.

113. Po në rubrikën të dhëna arkivore të raportit të KLP-së, konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 23.02.2021, drejtuar KLP-së, se më 21.11.2017 është regjistruar me nr. *** kallëzimi i shtetasit S.K. kundër shtetasit Erind Reovica. Nga aktet bashkëngjitur shkresës rezultoi se: (i) është regjistruar procedimi penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit S.K., i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/25 dhe 279 të Kodit Penal; (ii) shtetasi S.K. ka bërë kallëzim penal ndaj prokurorit Erind Reovica për veprën penale “shpërdorimi i detyrës” dhe “fillim i paligjshëm i ndjekjes penale” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; (iii) Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka dërguar për kompetencë materialin kallëzues të shtetasit S.K., Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

113.1 Nga analiza e akteve shkresore rezultoi se në kallëzimin e penal, kallëzuesi S.K. pretendon se duke mos u provuar fajësia e tij, prokurori Erind Reovica ka konsumuar veprën penale të parashikuar në nenin 313 (fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale) të Kodit Penal, ndërsa për sa i përket shpërdorimit të detyrës, pretendon se subjekti i rivlerësimit ka shkelur rëndë ligjin duke mos respektuar nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me zgjatjen e afateve.

Në lidhje me këtë kallëzim, në datën 13.12.2017, është marrë vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, nga prokurori N.P., prokurorë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, vendim i cili nuk është ankimuar, ku është arsyetuar se: (i) sa i takon veprës penale të parashikuar në nenin 313 të Kodit Penal, nga analiza e dokumentacionit të administruar nga dosja penale në ngarkim të shtetasit S.K., ka ekzistuar dyshimi i arsyeshëm bazuar në prova se ka qenë autor i veprës penale, objekt hetimi, dhe në bazë të këtyre provave Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur masën “arrest me burg”, lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit; (ii) sa i takon shpërdorimit të detyrës duke mos respektuar nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me zgjatjen e afateve, prokurorja e çështjes ka vlerësuar se nuk është element i veprës penale dhe se kallëzuesi nëse nuk është dakord me vendimin për zgjatjen e afatit, ka të drejtën e ankimit në gjykatë.

113.2 Sa i takon pretendimit të kallëzuesit se subjekti ka konsumuar veprën penale të parashikuar në nenin 313 (fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale), siç duket, kjo akuzë ka lidhje me vlerësimin e provave nga ana e subjektit për efekt të ngritjes së akuzave ndaj shtetasit S.K. Në zbatim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, është jashtë tagrit të Komisionit ta zëvendësojë interpretimin ose logjikën e prokurorit.

113.3 Sa i takon pretendimit për mosrespektim të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me zgjatjen e afateve, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit i është kërkuar të japë sqarime për veprimet e kryera nga ana e tij, duke i shoqëruar deklaratimet me aktet e ndodhura në dosjen e procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit S.K. Në parashtrimet e veta, subjekti ka deklaruar shkurtimisht se: *“Për sa më sipër, sqaroj Komisionin se për shkak*

se vepra penale ka qenë e rëndë dhe duke qenë se nga ana e familjarëve të viktimës janë kërkuar një sërë veprimesh hetimore pasi kanë pasur dyshime të shumta janë marrë vendimet e zgjatjeve të afateve të këtij procedimi penal. Faktorë të tjerë që kanë ndikuar në zgjatjen e afatit janë problemet shëndetësore të miat për shkak të aksidentit si masat e marra në kuadër të pandemisë (karantina)”. Subjekti nuk paraqiti asnjë dokument shkresor për të vërtetuar këto pretendime.

113.4. Siç vërehet, subjekti nuk ka përmbushur kërkesën e Komisionit për të dhënë shpjegime bazuar në aktet e dosjes procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit S.K., në lidhje me zgjatjen e afateve të hetimit. Ndërkohë që mbetet i pakuptimtë deklarimi sipas të cilit një faktor që ka ndikuar në zgjatjen e afatit janë problemet shëndetësore të tij për shkak të aksidentit si dhe masat e marra në kuadër të pandemisë (karantina), pasi si aksidenti që ka pësuar subjekti ashtu edhe pandemia për shkak të Covid-19, i përkasin vitit 2020 ndërkohë që procedimi penal, në ngarkim të shtetasit S.K., i përket vitit 2015.

114. Pasi nga KLP-ja është evidentuar se për vitet kalendarike subjekti ka marrë vlerësimin “mirë” për aftësitë profesionale nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në analizë të të gjitha të dhënave dhe materialeve që ka marrë në shqyrtim, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ky institucion ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit Erind Reovica si vijon:

114.1 Për aftësitë profesionale

a) *Njohuritë ligjore:* subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

b) *Arsyetimi ligjor:* subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

114.2. Për aftësitë organizative

a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë:* në periudhën e rivlerësimit ka trajtuar gjithsej 381 materiale. Subjekti i rivlerësimit ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Konkretisht, kohëzgjatja e trajtimit të praktikave që i korrespondojnë dosjeve 1, 2, 3, 4 dhe 5 ka qenë respektivisht: dosja nr.1 - kohëzgjatja (4 muaj e 16 ditë). Dosja nr. 2 - kohëzgjatja (3 muaj e 8 ditë). dosja nr. 3- kohëzgjatja (2 muaj e 7 ditë). Dosja nr. 4 - kohëzgjatja (1 muaj). Dosja nr. 5 - kohëzgjatja (12 ditë).

b) *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore:* subjekti i rivlerësimit merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) *Aftësia për të administruar dosjet:* nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, të njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe disponimin e gjykatës.

114.3 Për etikën dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) *Etika në punë:* nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) *Integriteti*: nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) *Paanësia*: nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

114.4 Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) *Aftësitë e komunikimit*: komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) *Aftësia për të bashkëpunuar*: bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

c) *Gatishmëria për t'u angazhuar*: subjekti Erind Reovica rezulton se nuk ka marrë pjesë në trajnime me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme

115. Si informacion i marrë nga burime të ligjshme janë konsideruar informacionet e marra nga: (i) tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e tij; (ii) tetë denoncime nga publiku, të administruara për subjektin e rivlerësimit, në 7 prej të cilave⁶⁸ nuk referoheshin shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit si dhe nuk ngriheshin pretendime mbi zvarritje hetimi, ku pas analizimit të tyre, bazuar në aktet e paraqitura, u konstatua se pretendimet ishin rrëzuar pas shqyrtimit gjyqësor në dy shkallë dhe për këtë arsye, Komisioni nuk e vlerësoi të nevojshme kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore. Për 1 denoncim është vlerësuar të kryhen verifikime nga Komisioni ose t'i kërkohej sqarime subjektit të rivlerësimit, trajtuar në vijim.

116. Në denoncimin e tij shtetasi A.M.⁶⁹ ngrinte pretendime për mos'hetim në themel të dosjes për sa i përket procedimit penal nr. ***, të hetuar nga subjekti i rivlerësimit Erind Reovica, duke paraqitur disa dokumente si: (i) vendim për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, datë 10.4.2018, të prokurorit Erind Reovica; (ii) procesverbal i pyetjes së të pandehurit, datë 14.4.2019; (iii) planvendosje, planrilevim dhe planimetri.

116.1 Me qëllim verifikimit të këtij pretendimi, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, dosjen e procedimit penal nr. ***, nga aktet e së cilës u konstatua se:

- Me urdhër, datë 8.5.2018, të prokurorit Erind Reovica është regjistruar procedimi penal nr. 697, mbi kallëzimin e shtetasve H.Th. dhe M.Th. për veprat penale "pushtim toke" dhe "falsifikim dokumentesh".

- Në datën 21.12.2018, shtetasi K.Th. ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ndaj shtetasve H.Th. dhe A.M., për kryerjen e veprës penale "mashtrim" dhe "falsifikim i dokumenteve" në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 143/2 dhe 186/2 të Kodit Penal.

⁶⁸Shihni denoncimet protokolluar në Komision: nr. **** prot., datë 19.4.2018; nr. *** prot., datë 16.1.2019; nr. *** prot., datë 22.5.2018; nr. *** prot., datë 24.5.2018; nr. *** prot., datë 5.10.2020; nr. *** prot., datë 11.6.2019; dhe nr. *** prot., datë 20.10.2020.

⁶⁹Shihni denoncimin, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 5.6.20019.

- Me urdhër të datës 31.12.2018, prokurorja V.Sh. ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. *** për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal (pa emër personi ndaj të cilit atribuohet vepra penale).

- Me vendimin, datë 31.12.2018, prokurori Erind Reovica ka vendosur bashkimin e procedimit penal nr. ***, datë 8.5.2018 dhe nr. ***, datë 31.12.2018.

- Me urdhër, datë 4.4.2019, për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, të prokurorit Erind Reovica, është urdhëruar regjistrimi i emrave të shtetasit A.M. për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve“, në bashkëpunim, i parashikuar nga nenet 186/3 dhe 25 të Kodit Penal dhe shtetasit H.Th. për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve“, në bashkëpunim, i parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

- Me vendimin, datë 5.4.2019 të prokurorit Erind Reovica është vendosur ndarja e çështjes së procedimit penal nr. *** nga fashikulli i procedimit penal nr. ***.

- Me vendimin, datë 10.4.2019, prokurori Erind Reovica ka vendosur për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës ndaj shtetasit A.M. dhe të shtetasit H.Th.

- Me njoftim, datë 10.4.2019, të prokurorit Erind Reovica janë njoftuar për përfundimin e hetimeve shtetasit A.M. dhe H.Th.

116.2. Nga subjekti Erind Reovica janë kryer veprimet hetimore si vijojnë:

- me vendim të datës 11.2.2019 prokurori Erind Reovica, në lidhje me procedimin penal nr. ***, ka vendosur sekuestrimin e praktikës për aplikim legalizimi objekti pa leje të shtetasit H.N.Th.;

- me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2019, drejtuar Bashkisë Fier, është kërkuar informacion mbi punonjësit që kanë qenë në funksion përgjegjës dhe specialist, në zyrën e aplikimeve;

- me shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2019, drejtuar Këshillit të Qarkut Fier, është kërkuar vënien në dispozicion e fragmentit të hartës së qytetit Fier, z. k. ***;

- me shkresat nr. *** prot., datë 16.1.2019 dhe nr. *** prot., datë 6.2.2019, Prokuroria Fier drejtuar Bashkisë Fier ka kërkuar vënien në dispozicion fragment të hartës së qytetit Fier, z. k. ***;

- me shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është kërkuar kopje e vendimit civil nr. ***, datë 7.7.1993 dhe nr. ***, datë 9.9.1992;

- me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2018, drejtuar ZVRPP-së Fier, është kërkuar dosja e regjistrimit të pronësisë për pasurinë nr. *** z. k. ***, në emër të shtetasit K.Th.;

- sipas procesverbalit të datës 18.1.2019, nga oficeri i policisë gjyqësore R.Z., janë këqyruar banesat e shtetasve K.Th. dhe H.Th.;

- është administruar dosja civile nr. vendimi ***, datë 14.6.2018 me paditës K.Th. dhe i paditur H.Th., të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;

- me shkresë nr.*** prot., datë 5.2.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është kërkuar vendimi penal nr. ***, datë 26.7.2012, me të pandehur shtetasin A.M.;

- është administruar aktekspertimi datë 8.5.2019, i ekspertit inxh. F.P., të kryer sipas vendimit të oficerit të policisë gjyqësore me datë 27.3.2018;

- janë administruar: procesverbali, datë 9.4.2019, i këqyrjes dhe marrjes së dokumentacionit të ndodhur në dosjen penale nr. ****, ndarë nga procedimi penal nr. ***; procesverbale të datave 5.3.2019, 11.3.2019 dhe 15.3.2019, për marrjen e të dhënave nga shtetasit E.G., S.Ll. dhe F.B.; procesverbali i datës 19.4.2019 për njohjen e viktimave me të drejtat (shtetasit K.Th.); procesverbali i datës 28.3.2019 për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale të shtetasit A.M.; procesverbale në datat 14.4.2019 dhe 17.5.2019, i pyetjes së të pandehurve A.M. dhe H.Th.;

- në datën 1.7.2019 çështja është dërguar për gjykim;

- me vendimin datë 4.11.2019, nr. akti ***, datë regjistrimi 1.7.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke urdhëruar kryerjen e detyrave të lëna në pjesën arsyetuese të vendimit si: (i) të hetohet në lidhje me trashëgiminë ligjore; (ii) të bëhet këqyrja pranë arkivit të noteres dhe ZVRPP-së Fier; (iii) të bëhet aktekspertimi për kontratën e shitjes nr. ***, datë 19.2.1988 dhe për notë transkriptimi; (iv) të hetohet dhe të kryhen verifikime mbi ndërtesën që kërkohet për t'u legalizuar; (v) të hetohet procedura ligjore e regjistrimit të pronës; (vi) të hetohet për objektin nëse ka kontratë energjie elektrike;

- pas vendimit të gjykatës vërehet se çështja i ka kaluar për shqyrtim prokurores S.B.

116.3. Bazuar në sa më sipër, duket se nga subjekti nuk janë kryer disa veprime hetimore të evidentuara nga gjykata në vendimin me datë 4.11.2019 si më sipër, midis të cilave edhe kryerja e një aktekspertimi për kontratën e shitjes nr. ***, datë 19.2.1988 dhe për notë transkriptimi, fakt i pretenduar edhe nga denoncuesi. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me këto konstatime.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar shkurtimisht se: *“Në lidhje me këtë procedim ju bëjmë me dije se bazuar në bindjen time të brendshme kanë kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe më pas kam kryer të gjitha veprimet hetimore të lëna nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, por duke qenë se shtetasi H.Th. nuk ka qenë në Shqipëri për të bërë të mundur bashkëpunimin e tij, si dhe për të përcaktuar pretendimet e tij. Nga ana e ekspertës N.K. nuk është realizuar në kohë aktekspertimi teknik pasi (sipas pretendimit të ekspertës ka qenë me Covid-19 arsyeja). Siç ju kam vënë në dijeni edhe më parë në datën 16.1.2020 kam bërë një aksident rrugor ku kam qenë me raport për një periudhë dymujore dhe më pas janë vendosur masat anticovid (karantina)”. Subjekti nuk ka paraqitur dokumente shkresore për të vërtetuar pretendimet e tij.*

116.4 Siç vërehet, subjekti nuk ka përmbushur kërkesën e Komisionit për të argumentuar me shpjegime e dokumente shkresore moskryerjen e disa veprimeve hetimore të evidentuara nga gjykata në vendimin me datë 4.11.2019, ose të vërtetonte mungesën e nevojës për të kryer këto veprime hetimore. Ndërkohë që mbetet i pakuptimtë argumenti se në datën 16.1.2020 subjekti ka bërë një aksident rrugor dhe ka qenë me raport për një periudhë dymujore dhe më pas janë vendosur masat anticovid (karantina), pasi si aksidenti që ka pësuar subjekti ashtu edhe pandemia për shkak të Covid-19, i përkasin vitit 2020, ndërkohë vendimi i gjykatës që ka evidentuar moskryerjen e disa veprimeve hetimore, është i datës 4.11.2019, fakt që tregon se çështja penale është trajtuar më parë nga subjekti.

Informacion i marrë nga mediat online

117. Shtetasi S.F. ka paraqitur një denoncim në median Top - Channel⁷⁰, në të cilin pretendon se është aksidentuar në nëntor të vitit 2017 dhe pas 1 viti nga aksidenti, prokuroria ka pushuar hetimet me argumentin se *“drejtuesi i mjetit nuk ka shkelur rregullat e qarkullimit”*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka urdhëruar prokurorinë të rihetonte ngjarjen dhe brenda 30 ditësh ta dërgonte dosjen për hetim. Denoncuesi pretendon se çështja është ndjekur nga prokurori Erind Reovica dhe megjithëse kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga kjo ngjarje, prokuroria nuk ka bërë asnjë veprim hetimor *“duke e lënë në sirtar”*.

117.1. Me qëllim vërtetimit të pretendimeve të denoncuesit, me kërkesë të Komisionit, Prokuroria Fier vuri në dispozicion dosjen e procedimit penal nr.*** të vitit 2017, nga aktet e së cilës konstatohet se:

⁷⁰Shihni: https://top--channel-tv.translate.google.com/2020/10/22/fiks-fare-prokurori-3-vjet-dosjen-ne-sirtar-kercenonte-gjymtuarin-a-do-ikesh-apo/?_x_tr_sl=sq&_x_tr_tl=en&_x_tr_hl=en-US&_x_tr_pto=nui,op,sc+.gbb

- me urdhrin e datës 20.11.2017, prokurori Erind Reovica ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” në ngarkim të shtetasit L.A.;
- me urdhrin e datës 22.11.2017 “Për delegimin e veprimeve hetimore” është urdhëruar kryerja e një sërë veprimesh hetimore, brenda datës 15.12.2017;
- me kërkesën e datës 9.2.2018 prokurori Erind Reovica ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr.***, datë 20.11.2017 për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” pasi nga ana e shtetasit L.A. nuk është kryer shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor;
- me vendimin e datës 20.2.2018 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.5.2018, duke përshkruar veprimet hetimore të kryera deri në atë moment, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- me vendimin e datës 20.5.2018 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.8.2018, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në vendimin e mëparshëm, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- me vendimin e datës 20.8.2018 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.11.2018, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në dy vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 3.10.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve sipas drejtimeve të lëna nga gjykata brenda një afati prej 30 ditësh, të tilla si: pyetja e shtetasit S.F.; administrimi i kartelës shëndetësore të viktimës, ditën e ngjarjes pranë spitalit të Fierit; kryerja e një akti të ri ekspertimi autoteknik nga një grup ekspertësh;
- me vendimin e datës 20.11.2018 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.2.2019, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në tri vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- me vendimin e datës 20.2.2019 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.5.2019, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në katër vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- me kërkesën e datës 24.4.2019, shtetasi S.F. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesën për zëvendësimin e prokurorit Erind Reovica nga hetimi i procedimit penal nr.***, i vitit 2017 për shkak të moskryerjes së hetimeve, tejkallimit të afateve dhe mospërmbushjes së detyrave të lëna nga gjykata; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 26.4.2019, ka shpallur mungesën e juridiksionit në lidhje me shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier për marrjen në shqyrtim të kësaj kërkesë;
- me vendimin e datës 20.5.2019 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.8.2019, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në pesë vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- me vendimin e datës 20.8.2019 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.11.2019, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në gjashtë vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- me vendimin e datës 20.11.2019 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.2.2020, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në shtatë vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- me vendimin e datës 20.2.2020 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.5.2020, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në tetë vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- me vendimin e datës 20.5.2020 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.8.2020, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në nëntë vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;

- me vendimin e datës 20.8.2020 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.11.2020, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në dhjetë vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- me vendimin e datës 20.11.2020 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.2.2021, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në njëmbëdhjetë vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- me vendimin e datës 20.2.2021 prokurori Erind Reovica ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve deri më 20.5.2021, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në dymbëdhjetë vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje;
- po në këtë datë, 20.2.2021, prokurori ka vendosur kryerjen e riekspertimit autoteknik;
- me kërkesën e datës 13.4.2021, prokurori Erind Reovica ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr.**, të vitit 2017 për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”. Në këtë kërkesë evidentohet kryerja e aktit të riekspertimit autoteknik të datës 28.2.2021;
- në datën 19.4.2021 është urdhëruar paraqitja në prokurori e shtetasit S.F., i cili është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale në datën 27.4.2021.

117.2. Në përfundim, nga analiza e akteve të dosjes penale, duket se:

- i) ka zvarritje të hetimeve nga subjekti i rivlerësimit Erind Reovica, në cilësinë e prokurorit të çështjes, pasi konstatohen 13 vendime për shtyrje të afatit të hetimeve, të cilët janë me përmbajtje të njëjtë (*copy paste*), përveç datave, dhe të paarsyetuar në drejtim të shkaqeve të shtyrjes së afatit dhe pamundësisë për t’i përfunduar hetimet brenda afatit të caktuar sipas kritereve të pikës 2, të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale;
- ii) nuk ka urdhër të prokurorit për rifillimin e hetimeve pas vendimit nr. ***, datë 3.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve sipas drejtimeve të lëna nga gjykata brenda një afati prej 30 ditësh;
- iii) veprimet hetimore të lëna si detyrë janë bërë jashtë çdo afati të caktuar nga gjykata, pasi rezultojnë të jenë kryer pas një periudhe prej gati 2 vitesh nga vendimi i gjykatës (veprimi i parë hetimor që ka qenë kryerja e riekspertimit teknik është kryer në datën 20.2.2021, kurse veprimi tjetër hetimor pyetja e shtetasit S.F. është kryer në datën 27.4.2021);
- iv) nga prokurori i çështjes nuk janë kryer veprime hetimore për një periudhë gati 2-vjeçare.

117.3 Gjithashtu, me kërkesë të Komisionit, SPAK-u⁷¹ ka bërë me dije se ndaj shtetasit Erind Reovica ka ardhur material kallëzues nga shtetasi S.F., i cili është vendosur të dërgohet për vlerësim me shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë arsye, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me vijimësinë e këtij procedimi penal.

117.4 Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të japë sqarime e paraqesë dokumente në lidhje me këto konstatime, si dhe të japë sqarime mbi vendimmarrjen e gjykatës pas kërkesës së fundit të subjektit për pushimin e procedimit penal. Në parashtrimet e veta, subjekti ka sqaruar shkurtimisht se: *“Në lidhje me këtë procedim ju bëjmë me dije se janë kryer të gjitha veprimet hetimore të lëna nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Veprimet hetimore të lëna si detyrë janë kryer jashtë afatit të caktuar nga gjykata, për shkak se të paaftësisë së përkohshme në punë për shkak të aksidentit të kryer, si dhe për shkak se pas këtij momenti janë marrë masat në kuadër të pandemisë, kohë gjatë së cilës aktiviteti edhe i prokurorisë është pezulluar (karantina)”. Subjekti nuk paraqiti asnjë dokument në mbështetje të pretendimeve të tij. Gjithashtu, në parashtrimet e tij, subjekti nuk dha asnjë sqarim a dokument shkresor në lidhje me vijimësinë e procedimit penal ndaj tij me kallëzim të shtetasit*

⁷¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.12.2021, të SPAK-ut në dosjen e Komisionit.

S.F., nga ana Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal.

117.5 Siç vërehet, subjekti nuk ka dhënë sqarime, argumente dhe dokumente shkresore në lidhje me të gjitha konstatimet e Komisionit për të cilat i ka kaluar barra e provës. Ndërkohë që, në mënyrë të përsëritur, i është referuar paaftësisë së përkohshme në punë si dhe situatës për shkak të Covid-19, si shkaqe për kryerjen e veprimeve hetimore jashtë afateve.

Sa i takon paaftësisë për punë, referuar raporteve mjekësore të datës 20.1.2022, subjekti ka qenë i paaftë pune për periudhën 16.1.2020 deri më 18.3.2020⁷².

Sa i takon masave të marra në kudër të pandemisë Covid-19, sipas aktit normativ nr. 9, datë 25.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, pika 2 e nenit 3 përcakton se: “Nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e Covid-19 pezullohen afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve, si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, sipas parashikimeve në këtë akt normativ. Kur afatet fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë”. Ndërsa, me aktin normativ nr. 21, datë 27.5.2020, “Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr. 30/2020”, është vendosur shfuqizimi i pikës 2 të nenit 3.

Sa më sipër, rezulton se pretendimet e subjektit për shtyrjen e afateve mund të justifikohen vetëm për periudhën 16.1.2020 deri më 27.5.2020, por mbetet i pakuptimtë pretendimi i subjektit që gjendja e paaftësisë së tij për punë dhe gjendja e pandemisë, kanë qenë shkak i zvarritjes së hetimeve, para se ato të kenë ndodhur, si dhe pas përfundimit të tyre.

118. Sipas një denoncimi nga emisioni “****” në Top-Channel⁷³, ngrihen pretendime se shtetasi R.F. ka paguar shumën 20.000 euro në polici, në prokurori dhe ekspertëve për t’u liruar nga burgu. Për rastin e denoncuar nga djali i viktimës, shtetasi E.Sh., ngrihen pretendimet se: (i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendosi masën e sigurisë “arrest me burg” për shtetasin R.F. dhe Gjykata e Apelit Vlorë ndryshoi këtë masë, duke vendosur “arrest shtëpie” dhe vlerësoi se nëse do të ketë raporte të tjera, prokuroria mund të kërkojë ndryshimin e masës së sigurisë. Me vijimin e hetimeve, ekspertët rrugorë dolën në konkluzionin se fajtor ishte pikërisht shtetasi Ritnalt Fetahaj, por prokurori i çështjes Erind Reovica nuk kërkoi në gjykatë ndryshimin e masës së sigurisë, duke vijuar ta hetojë me masën “arrest shtëpie”; (ii) i arrestuari R.F. ka thyer masën “arrest shtëpie” duke qarkulluar dhe punuar i lirë në qytetin e Fierit.

118.1. Në analizë të pretendimeve, vendimmarrja prokurorit për kërkesën për ndryshimin e masës së sigurisë, vlerësohet se në zbatim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, del jashtë tagrit të Komisionit. Ndërsa me qëllim verifikimin e faktit të denoncuar se i arrestuari Ritnalt Fetahaj, ka thyer masën e sigurimit “arrest shtëpie”, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime për sa pretendohet në këtë media, se i arrestuari ka shkelur detyrimet që lidhen me masën e sigurimit “arrest shtëpie”. Gjithashtu, subjektit i është kërkuar të paraqesë dokumente nga dosja penale si: kontrollet për respektimin e urdhrave që i janë dhënë të pandehurit, etj.

118.2. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar shkurtimisht se: “Në lidhje me denoncimin në mendja ju bëj më dije se nga ana e Prokurorisë Fier nuk është ndryshuar masa e sigurisë

⁷²Shihni raportet mjekësore bashkëlidhur në kërkesën e bashkëshortes së subjektit N.R., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 22.1.2020, me të cilën ka kërkuar shtyrje të afatit në lidhje me kthim përgjigje të pyetësorit standard.

⁷³Shihni: https://www-faxweb-al.translate.google/20-mije-euro-shpeton/?_x_tr_sl=sq&_x_tr_tl=en&_x_tr_hl=en-US&_x_tr_pto=nui,op,sc

për këtë shtetas. Në momentin e publikimit të lajmit, ky procedim ka qenë në gjykim dhe nga ana ime si prokuror është kërkuar masa e dënimit me 10 vjet burgim”.

Siç vërehet, subjekti nuk dha asnjë sqarim në lidhje me pretendimin e denoncuesit, se i arrestuari R.F. ka thyer masën e sigurimit “arrest shtëpie”, si dhe nuk paraqiti asnjë dokument nga dosja penale.

119. Sipas artikullit të publikuar në media, “***”⁷⁴, në datën 17.7.2021 kryetari i fshatit N***-L*** dhe banorët kanë depozituar në SPAK një kallëzim penal ku rezulton se shtetasi D.Ç. është akuzuar për falsifikim dokumentesh zyrtare dhe private, vjedhjes me anë të mashtrimit të pronës private e shtetërore dhe korrupsion me zyrtarët e shtetit.

Në kuadër të rivlerësimit të pasurisë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka blerë një apartament me kontratë nr. ***, datë 9.7.2014 nga shoqëria “R.” sh.p.k. me administrator z.D.Ç., duke ndryshuar një marrëveshje të mëparshme për blerjen e një apartamenti tjetër (trajtuar në paragrafët 46 - 46.5 të vendimit). Me qëllim verifikimi të një konflikti të mundshëm të interesit të subjektit me shtetasin D.Ç. dhe shoqërisë “R.” sh.p.k., si dhe përfshirjes në veprimtari kriminale të tij, me kërkesë të Komisionit, Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Vlorë dhe Fier, ku subjekti ka ushtruar detyrën, nuk konfirmuan kallëzime/procedime penale të hetuara nga subjekti për shtetasin D.Ç. dhe shoqërinë “R.” sh.p.k., si dhe SPAK nuk ka konfirmuar procedime penale të regjistruara në emër të shtetasit D.Ç.

120. Artikull i publikuar në gazetën “*”, në lidhje me shtetasin B.E.⁷⁵**

Sipas artikullit të publikuar në gazetën “***” rezulton se, sipas disa dëshmimeve, tre shtetasve boshnjakë të përfshirë në trafikun e heroinës, u janë dërguar para nga Shqipëria, midis të cilëve dhe nga shtetasi B.E., i cili i ka dërguar 3.000 euro shtetasit N.C. në Sarajevë. Në kuadër të rivlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shtetasi B.E. është mik i tij, të cilit i ka dhënë dhe një hua në datën 15.2.2015, në shumën 17.000 euro. Gjithashtu, nga vetë deklaratimet e subjektit rezulton se ai do të hapte një aktivitet privat me një shtetas me emrin B., i cili dyshohet të jetë B.E.

Më qëllim verifikimit të një konflikti të mundshëm të interesit dhe përfshirjes në veprimtari kriminale të shtetasit B.E., me kërkesë të Komisionit, prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore nuk konfirmuan çështje të trajtuara nga subjekti në lidhje me këtë shtetas, ndërsa SPAK-u nuk konfirmoi procedime penale ndaj shtetasit B.E.⁷⁶

Qëndrimi i subjektit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

121. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- Fillimisht ka shprehur pikëpamjen e tij të përgjithshme për procesin e rivlerësimit duke deklaruar midis të tjerash se: “... ky proces është veçanërisht i ndjeshëm në dritën e nevojës për të shmangur dëmtimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në ushtrimin e pavarur të diskrecionit gjyqësor, se treguesit kryesorë për vlerësim sigurohen nga ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe përfshijnë nivel të pamjaftueshëm të njohurive, aftësive, gjyqësive ose aftësive, ose kur ekziston një model i punës, i cili nuk përputhet me

⁷⁴Shihni: https://joq--albania-com.translate.google/artikull/899215.html?_x_tr_sl=sq&_x_tr_tl=en&_x_tr_hl=en-US&_x_tr_pto=nui,op,sc

⁷⁵https://www-panorama-com-al.translate.google/pergjimet-njeri-prej-jush-te-vije-urgjentisht-ketu-te-sqaroje-muhabetet-trafiku-i-droges-si-grupi-i-endrit-dokles-i-beri-shqiptare-3-boshnjaket/?_x_tr_sch=http&_x_tr_sl=sq&_x_tr_tl=en&_x_tr_hl=en-US&_x_tr_pto=nui,op,sc

⁷⁶Shihni shkresat: nr.*** prot., datë 20.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. **** prot., datë 25.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. *** prot., datë 19.10.2021, të SPAK-ut në dosjen e Komisionit; nr. *** prot., datë 9.11.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, bashkëngjitur informacionin e përcjellë nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve.

pozitën e tij/saj”. Subjekti ka cituar disa parashikime ligjore të ligjeve nr. 84/2016 dhe nr.96/2016, si dhe parashikime të Kushtetutës, në lidhje me këtë kriter.

- Sipas subjektit, nga analiza e dosjeve të dorëzuara nga ana e tij ashtu edhe ato të zgjedhura me short, nuk kanë rezultuar problematika dhe se nga burimet arkivore nuk rezulton të ketë pasur masa disiplinore, materiale hetimore të regjistruara, procedime penale të pushuara apo të pezulluara ndaj tij.

- Sipas subjektit, konkluzionet e Komisionit nuk qëndrojnë, por edhe sikur për një moment të vlerësohej se ndonjë prej tyre është i bazuar, në të gjitha rastet nuk konstatohen gabime që tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar. Në të gjitha konkluzionet e konstatuara nuk konstatohet ndonjë shkelje e rëndë.

- Subjekti pretendon se është i hapur për verifikim duke deklaruar se ka dhënë shpjegime dhe dorëzuar prova për çdo pikë të trajtuar nga Komisioni e duke theksuar se në nenin 41/3 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *“Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji”*. Bazuar në këtë parashikim ligjor është përcaktuar nga organet e vettingut se periudhë rivlerësimi është periudha tetor 2013 – 2016.

- Sipas subjektit, organet e rivlerësimit kontrollojnë figurën, profesionalizmin dhe mënyrën e krijimit të pasurisë nga magjistratët në të shkuarën dhe nuk kanë kompetencë të verifikojnë figurën, profesionalizmin dhe mënyrën e krijimit të pasurisë së magjistratëve në detyrë, për periudhën pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 86/2014. Këtë kompetencë e kanë organet e tjera të krijuara në kuadër të reformës në drejtësi.

- Sipas subjektit, në përfundim të analizës, Komisioni duhet të arrijë në konkluzionin se ka arritur nivel të mirë të vlerësimit profesional.

Vlerësimi i Komisionit

122. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni konstatoi se:

Së pari, sa i takon referimit të analizimit të tri dosjeve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të shortuara sipas ligjit, nga ana e Komisionit vlerësohet se pavarësisht se nga ana e KLP-së, nuk janë evidentuar problematika dhe mangësi në trajtimin e çështjeve përkatëse, këto dosje përbëjnë vetëm një pjesë të informacioneve të marra në rrugë ligjore në kuptim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, të cilave Komisioni iu referohet për efekt të rivlerësimit profesional sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.

Së dyti, sa i takon të dhënave nga burimet arkivore, me njoftimin e rezultateve të hetimit Komisioni i ka kërkuar sqarime dhe dokumente subjektit të rivlerësimit në lidhje me dy ankesa për të cilat ka dhënë deklaramë të pakta, pa paraqitur argumente dhe dokumente shkresore në lidhje me sa i është kërkuar (trajtuar me sipër).

Së treti, subjekti pa të drejtë është shprehur në çdo rast se konkluzionet e Komisionit nuk qëndrojnë, pasi të gjitha sa Komisioni ka evidentuar gjatë procesit të rivlerësimit profesional nuk kanë qenë konkluzione, por konstatime, për të cilat subjekti i është kërkuar të japë sqarime dhe dokumente me kalimin e barrës së provës. Vetëm pas prapësimeve, shpjegimeve dhe dokumenteve që subjekti do të paraqiste, Komisioni do të arrinte në një konkluzion në analizë të çdo parashtrimit e prove shkresore që do të paraqitej nga subjekti.

Së katërti, subjekti pretendon se është i hapur për verifikim duke deklaruar se ka dhënë shpjegime dhe dorëzuar prova për çdo pikë të trajtuar nga Komisioni. Përkundër sa pretendohet, në leximin e parashtrimeve në ushtrim të barrës së provës, evidentohet lehtësisht

se subjekti ka dhënë shpjegime të pakta e të përgjithshme në lidhje me çdo konstatim, pa dhënë asnjë argument në funksion të kundërshtimit të barrës së provës, duke munguar të paraqesë prova dhe dokumente shkresore të çdolloji.

Së pesti, subjekti deklaroi se edhe sikur për një moment të vlerësohej se ndonjë nga konkluzionet e Komisionit është i bazuar, sipas tij, nuk konstatohen gabime të cilat mund të konsiderohen shkelje të rëndë. Ndërkohë, vërehet se ky pohim është në nivel deklarativ, pasi në asnjë rast subjekti nuk është përpjekur të vërtetojë me argumente dhe dokumente shkresore peshën specifike të gabimeve e të metave të evidentuara, me qëllim vërtetimin e faktit se këto gabime e të meta janë pa pasoja dhe nuk përbëjnë shkelje të rënda.

Së gjashti, sa i takon pretendimit se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të ligjit nr. 84/2016 duhet të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës dhe se pas kësaj periudhe ky vlerësim bëhet nga institucione të tjera kompetente, vlerësohet se nuk qëndron pasi bazuar në pikën 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme, vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet.

Së shtati, në seancën dëgjimore, pyetjes se perse në parashtrime nuk janë dhënë sqarime dhe dokumente në lidhje me konstatimet sa i takon vlerësimit profesional, përfaqësuesja e subjektit iu përgjigj se për realizimin e mbrojtjes i kishin ndarë detyrat me subjektin, ku ajo do të merrej vetëm me dy kriteret e para, ndërsa për kriterin profesional do merrej vetë subjekti. Ndërkohë, iu referua dhe faktit se subjekti ka qenë me raport mjekësor, gjë që ka ndikuar në mosmarrjen e dosjeve.

Këto argumente të znj. A.S. nuk justifikojnë mungesën e paraqitjes së parashtrimeve dhe dokumenteve, sa i takon kriterit profesional për shkak se: (i) rezultatet e hetimit i janë dërguar subjektit të rivlerësimit në datën 13.1.2022, ndërkohë që raporti mjekësor i paraqitur me e-mail-in e datës 2.2.2022, me një afat pesëditor, tregon paaftësinë e tij të përkohshme në punë nga data 2.2.2022 në datën 6.2.2022. Pra, subjekti ka pasur 20 ditë kohë në dispozicion për të kërkuar materiale shkresore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, ku ushtronte detyrën; (ii) edhe në rast të pamundësisë objektive të subjektit për të kërkuar e marrë dosjet a dokumente shkresore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, avokatja e caktuar prej tij, ka pasur të gjithë mundësinë dhe të drejtën që të kërkonte tërheqjen e tyre nëpërmjet prokurorës së përfaqësimit; (iii) ndarja e detyrave sipas deklarimeve të avokates A.S., e cila do të merrej me kriterin pasuror dhe atë të kontrollit të figurës, duket pa logjikë, në kushtet kur znj. A.S., si një juriste me përvojë dhe, për më tepër ish-prokurore, do të ishte shumë më tepër kompetente në ushtrimin e mbrojtjes së saj sa i takon kriterit profesional. Në këto kushte, deklaratimet e znj. A.S. në seancë duken se janë justifikime për mosveprimet e subjektit të rivlerësimit në ushtrim të barrës së provës në lidhje me kriterin profesional.

Vlerësimi përfundimtar në lidhje me kriterin e aftësive profesionale

123. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, sipas parashikimeve në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës.

Në vlerësim të të gjitha rrethanave dhe fakteve të evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, përshkruar më sipër në vendim, u konstatua se pretendimi i subjektit sipas të cilit ai ka arritur nivel të mirë të vlerësimit profesional, është i pabazuar dhe i pavërtetuar, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë: (i) subjekti nuk ka dhënë ose ka dhënë shpjegime të përcipta në lidhje me të gjitha konstatimet e Komisionit, si dhe nuk ka paraqitur në asnjë rast dokumente shkresore nga dosjet penale të evidentuara, duke mos vërtetuar në çdo

rast të kundërtën e barrës së provës; (ii) mbrojtja e subjektit është bazuar kryesisht në disa argumente sipërfaqësore, sipas të cilave gabimet jothelbësore (por të paprovuara nga ana e tij) nuk mund të përbejnë shkak për penalizim të tij, apo, se pa të drejtë Komisioni ka analizuar aftësitë e tij profesionale jashtë periudhës trevjeçare të vlerësimit; (iii) deklaratimet e tij, duke iu referuar në mënyrë të përsëritur dhe të gabuar situatës së pandemisë për Covid-19 apo aksidentit rrugor të ndodhura në vitin 2020, për çështje të trajtuara prej tij përpara këtij viti, përveçse nuk justifikojnë në asnjë rast tejzgjatjen e përsëritur të afateve të hetimit, mungesën e arsytimit të vendimeve për zgjatjen e hetimit apo moskryerjen e detyrave të lëna nga gjykata, tregojnë mungesë serioziteti në kthimin e përgjigjeve dhe bashkëpunimin me Komisionin; (iv) subjekti nuk mundësoi prezencën e tij në seancën dëgjimore, me qëllim që nëpërmjet deklaratimeve të tij apo pyetje-përgjigjeve, t'i jepte mundësinë Komisionit të vlerësonte qëndrimet e tij sa i takon konstatimeve të evidentuara me kalimin e barrës së provës. Për më tepër, nga subjekti apo edhe nga përfaqësuesja ligjore nuk u paraqit ndonjë arsye apo dokument shkresor që të justifikonte mungesën e tij në seancën dëgjimore. Në këtë mënyrë, subjekti ka penguar dhe vështirësuar procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale nga ana e Komisionit, që sipas parashikimit të nenit E pika 5 të Aneksit të Kushtetutës, prezumohet si shkak në favor të masës disiplinore.

124. Bazuar në sa më sipër është arsyetuar e konstatuar në vendim, në përfundim të procesit, referuar në parashikimet e ligjit nr. 96/2016, nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, orientimet e Kolegjtit në vendimin nr. 21/13.9.2019 për subjektin e rivlerësimit G.M., trupi gjykues vlerësoi se subjekti Erind Reovica nuk vërtetoi në asnjë prej rasteve të referuara në rezultatet e hetimit që: (i) ka treguar aftësi të mira profesionale sipas parashikimit të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) ka treguar aftësi të mira organizative sipas parashikimit të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; si dhe, (iii) me qëndrimin e tij ndaj konstatimeve të Komisionit apo dhe ndaj vetë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale ka treguar mungesë etike dhe angazhim ndaj provueshmërisë së vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016. Për më tepër, subjekti nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin në procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, që sipas nenit 48 të ligjit 84/2016, është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimarrjes, në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

125. Për këto arsye, sipas germës “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i papërshtatshëm” profesionalisht, pasi nisur nga konstatimet e Komisionit për të cilat nuk vërtetoi të kundërtën e barrës së provës, ka treguar cilësi të papranueshme në punë, hetim të dobët, si dhe nuk ka respektuar normalisht të drejtat pjesëmarrësve në proceset penale të verifikuara, kryesisht për shkak të zgjatjes në mënyrë të përsëritur dhe të pajustificuar të hetimeve. Gjithashtu, qëndrimi i subjektit në lidhje me çdo konstatim të Komisionit, justifikimet në lidhje me mungesën e përgjigjeve dhe mosvënien në dispozicion të dokumentacionit nga dosjet penale të kërkuara, janë vlerësuar si elemente që cenojnë besimin e tij në publik si pjesë e sistemit të drejtësisë.

IV. SEANCA DËGJIMORE

126. Në datën 8.2.2022, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Erind Reovica. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit, znj. A.S., shprehu qëndrimin e saj, duke dhënë sqarime të mëtejshme mbi rezultatet e hetimit administrativ, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj subjektit të rivlerësimit, duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues, dhe duke kërkuar në përfundim konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Në datën 10.2.2022 u zhvillua seanca, në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erind Reovica.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

127. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti, përgjithësisht ka qenë i gatshëm e bashkëpunues, por, pasi është njohur me mbylljen e hetimit administrativ, në mënyrë të përsëritur ka kërkuar shtyrje të afatit për kthimin e përgjigjeve apo edhe të seancës dëgjimore për arsye jo gjithmonë të përligjura e të justifikuara objektivisht. Sa i takon vlerësimin të aftësive profesionale, subjekti nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin për arsye të përmendura hollësisht në trajtimin e aftësive profesionale. Qëndrimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

VI. KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

Bazuar në parimet e parashikuara në pikën 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në Aneksin e Kushtetutës dhe në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi që vendimmarrja për subjektin Erind Reovica të bazohet në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë dhe atë të vlerësimit profesional, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2014. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave ligjore të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Erind Reovica ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Erind Reovica rezultoi në papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

- Nga vlerësimi tërësor i rrethanave, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, me veprimet dhe mosveprimet e tij, subjekti Erind Reovica ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit në pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 61, pikat 6 dhe 7 të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erind Reovica, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.2.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli